

Arsimi profesional
Shumë reforma për pak nxënës

Fq.4



BORXHI SHTETËROR
400 mijë euro kamata ditore!

Fq.7



Dua të vazhdoj historinë me këtë klub

Fq.19



Koha

www.koha.mk

E keqja nuk mund të mbisundojë të mirën

Fq.12-13



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3251 · e premte 22 dhjetor 2017 -7°C | +4°C

15 DEN

AKTUALE

Tre të arres-tuar për vrasjen e Burim Idrizit



Ngjarjet tragjike në lagjen Çair të Shkupit, nuk kanë të ndalur. Për shumë qytetarë të kësaj ane të Shkupit, skenat e dhunshme, me pasoja fatale, kanë ngjallur një brengë dhe frikë për të ardhmen e tyre dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Vrasja e 24 vjeçarit, Burim Idrizi... Fq.4

RAJON

Korrupsioni nuk po luftohet

Fq.14

KULTURË

Me mbledhë tok albanologë shqiptarë

Fq.18

GLOBI

Turpi britanik me personat e pastrehë

Fq.15



TAKIM I SHKURTËR DHE PA EPILOG

SELA NUK LËSHON PE, TOPI TE ZAEVI

Pas takimit me kryeministrin Zaev, Ziadin Sela akuzoi BDI-në si shkaktare të krizës në Qeveri dhe që e ka problematizuar dhe po i bën presion LSDM-së që Aleancës për Shqiptarët ti merret Shëndetësia. Për qëndrimin që ASH të mbajë Shëndetësinë, Sela u thirr në marrëveshjen politike për formimin e Qeverisë

Fq.3

Një gjykatës shqiptar te krimet e rënda

Shkup, 21 dhjetor - Pjesë e sektorit për krim të organizuar në Gjykatën Penale të Shkupit, me sistematizimin e fundit të gjykatësve, për herë të parë është caktuar një gjykatës shqiptar. Bëhet fjalë për gjykatësin Osman Shabani. Shqyrtimi dhe procedimi i lëndëve të krimit të organizuar dhe korrupsionit në GJPSH paraqet një rën prej punëve më komplekse sa i përket shpalljes së aktgjykimi. Kësisoj, kryetari i ri i GJPSH, Ivan

Xholev, ashtu siç bënë paraardhësit e tij, Vlladimir Paçevski, Tatjana Mihajlova e Stojançe Ribarev, së fundmi ua ka ndryshuar vendet e punës gjykatësve brenda sektorëve të gjykatës, të cilën ai e udhëheqë. Publikimi i emrave të gjykatësve të rinj që do t'i gjykojnë lëndët për krim të organizuar, nënkupton se në këtë pozitë janë kthyer gjykatës me përvojë të madhe, të cilët gjatë viteve të kaluar...

Fq.5



LAJMI I FUNDIT

NË MAVROVË MINUS 11 GRADË

Shkup, 21 dhjetor - Më ftohtë në mëngjesin e sotëm do të jetë në Mavrovë me minus 11 gradë të matura. Në Llazaropole dhe Kruševë minus 10, minus nëntë në Berovë, minus shtatë në Gjurishtë, minus gjashtë në Pozharan, Dibër dhe Topollčan, minus pesë në Kriva Pallankë, minus katër në Strumicë, Prilep, Ohër dhe Pretor, minus tre në Tetovë, Vinicë dhe Manastir, minus dy në Shtip, Shkup, Demir Kapi dhe Kumanovë, zero në Dojran dhe një gradë në Gjevgjeli. Dëborë ka në Mavrovë 12 centimetra, Dibër pesë, Kruševë dhe Pozharan tre dhe Berovë dy centimetra.

Moti në mëngjesin e sotëm do të jetë mesatar deri me vranësira të dukshme dhe ftohtë, vende-vende me erë mesatare veriore. Moti sot do të jetë me vranësira mesatare dhe ftohtë me erë të dobët deri në mesatare nga drejtimi verior. Në disa lugina paradite do të ketë vranësira të dukshme. Temperatura do të arrijë prej minus një deri në pesë gradë. Në Shkup do të mbajë mot me diell dhe i ftohtë me vranësira të vogla deri në mesatare dhe me erë të dobët deri në mesatare veriore. Temperatura do të arrijë deri në tre gradë. Në përgjithësi, moti do të jetë i thatë dhe i ftohtë me temperatura të ulëta të mëngjesit. Të shtunën do të ketë rritje të re të vranësirave, ndërsa në pjesët veriore dhe në male do të ketë reshje të kohëpaskohshme dhe të dobëta të borës. Do të fryjë erë e përforcuar veriore. Nga e diela sërish vijon periudhë e motit të qëndrueshëm dhe të thatë, nga e hëna rritje e temperaturave ditore.

SKADON AFATI PËR APLIKIM PËR MIRËNJOHJEN "SHKENCËTARI 2017"

Shkup, 21 dhjetor - Edhe dhjetë ditë zgjat mundësia për aplikim të Thirrjes publike për zgjedhjen e "Shkencëtarit të ri më të mirë" për vitin 2017, mirënjohje që e ndan presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov. Thirrja publike për zgjedhjen e "Shkencëtarit më të mirë të ri" për vitin 2017 është e hapur deri më 31 dhjetor për të gjithë të rinjtë deri në moshën 30 vjeçare, të cilët në punën e deritanishme shkencore kanë arritur rezultate të rëndësishme shkencore. Të interesuarit, dokumentet e tyre duhet t'i dorëzojnë deri te Kabineti i presidentit të RM-së. Kusht për konkurrimin e të interesuarve është që të kenë të marrë çmim ose mirënjohje për punë shkencore-hulumtuese, rezultatet nga puna shkencore-hulumtuese të publikohen dhe zbatueshmëri e rezultateve nga hulumtimi shkencor për vitin 2017. Ndarja e mirënjohjes "Shkencëtarit më të mirë të ri", në iniciativë të presidentit Ivanov, ka për qëllim ta nxitë zhvillimin dhe t'i stimulojë investimet në shkencë, t'i mbështesë institucionet shkencore dhe kuadrin e ri shkencor, por edhe t'i shpërblejë arritjet e larta shkencore. Aplikimi për pjesëmarrje të thirrjes publike duhet të mbajë biografi, projekte të realizuara në vitin 2017 me të cilat konkurrohet (në një kopje të shtypur dhe një elektronike - CD) dhe dëshmi për shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

KRYEMINISTËR, DISTANCOHU

"Kryeministër Ramush Haradinaj, po të drejtohem si ish komandant i UÇK, nëse nuk distancohesh publikisht nga fjalët e Nasim Haradinajt (që mund ta kesh edhe familjar), atëherë po e marrë që je në vijë me të. Nëse OVL e UÇK nuk e shkarkon prej pozite Nasimin, atëherë kjo nënkupton që edhe ata janë në mendim të njëjtë me të. Mos harroni që në mesin e të vrave me motive politike të veprimtarëve të LDK, disa prej tyre kanë qenë pjesë e UÇK", shkruan në profilin e saj në FB, Beriana Mustafa, vajza e Xhemajl Mustafës, në shenjë reagimi kundër përfaqësuesit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, i cili një ditë më parë në një debat televiziv ka thënë "punë e madhe që janë vra anëtarët e LDK-së".



SAKRALIZIMI I POLITIKËS

"Sakralizimi i politikës, shkruan Gentile, ndodh sa herë që një entitet politik - kombi, demokracia, shteti, raca, klasa, partia, lëvizja - shndërrohet në entitet sakral, në një objekt kulti e adhurimi, dhe vendoset në qendër të një sistemi besimesh, simbolesh e ritesh. Atëherë lindin fetë e politikës, të cilat nuk identifikohen me një tip të vetëm ideologjie apo regjimi: ato mund të sakralizojnë demokracinë ose autokracinë, barazinë ose pabarazinë, kombin ose njerëzimin", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Emin Azemi.



A IA VLEN TË JEMI TË NDERSHËM

"Na e keni bërë punën të themi 'nuk ia vlen të jesh i ndershëm'. S'mund të jetë demokratik, as i lirë, as perendimor, as normal, nuk meriton liberalizim vizash e as lëvizje të lirë, një shtet si Kosova ku punëtorët e sektorit privat trajtohen si skllëvër, ama, bash-bash si skllëvër, në mesjetë: Nuk i bëjnë hesap për njerëz; Shkoni kqyrni se në çfarë temperaturash të ulta punojnë ata sot! Ku është njerëzia! Ku i keni inspektorët e punës, Kryeministër, a ka mbetë naj njeri normal në këtë vend! I kërcënojnë me largim nga puna dhe i frikësojnë; Rrogat e vogla plus ua vonojnë, ua japin xhepa-xhepa; I detyrojnë me punu edhe për festa; I detyrojnë që të dielave me ua falsifiku artikujve ushqimor afatet e prodhimit (me acetone); Nuk kanë të drejtën e ankesës; Punojnë pa kontrata; Punëtori i shkretë (skllav qysh e keni bërë) ia ruan sytë pronarit, kur po e largon nga puna, a po më largon tash a tash", shkruan publicistja Kimete Berisha në profilin e saj në Facebook.



MORTJA TJETËR REFORMËN NË DREJTËSI

"Të lumturohesh se kujton që në 2017 Nexhmijen e hëngri mortja..., ndërsa Gramozin e ke kryetar parlamenti e do drejtojë ky mortja tjetër reformën në drejtësi. Në ndërkohë, për herë të parë në historinë politike, Sali Berisha, guxon të preket me forcë e të dhunohet nga Garda, ndërsa deputetët e opozitës i përjashton, i fut e i nxjerr Gramozin nga parlamenti si lepuj, vajzat e reja deputete e meritojnë edhe ndonjë shuplakë nga kolegët, kur nuk sillen mirë... e kjo s'kish bërë vaki as në '90..., por opozita është e lumtur se ja ngriu buzëqeshjen kryehajvanit...", shkruan ish-deputetja shqiptare Mesila Doda.



MEDIACitate

Autoritetet spanjolle kanë goditur një rrjet të fuqishëm të drogave të forta të drejtuar nga një shqiptar. Ai është një 39-vjeçar me iniciale V.V. i cili orientonte trafikun nga qyteti i Galicias. Në pranga u vunë edhe 6 anëtarë të tjerë të këtij grupi. Mediat spanjolle e etiketojnë 39-vjeçarin si "person të regjur" në botën e kriminit pasi është i përfshirë në trafik droge prej shumë vitesh. "Eskobari" shqiptar jetonte prej kohësh në Santiago de Compostela. Operacioni kishte nisur prej disa muajsh. Të hënën u konfiskua 4 kg kokainë, 1.7 kg heroinë dhe 500 gram lëndë përzierës për drogën. U sekuestruan edhe dy automjete.

(Lapsi.al, 21 dhjetor)

Në bazë të të gjeturave të auditorit thuhet se asnjë parti në Kosovë nuk ka një zyrtar të certifikuar si kontabilist me standardet e aplikueshme në Kosovë, dhe as nuk e udhëheq kontabilitetin sipas standardeve të nevojshme. Po ashtu sipas të gjeturave, thuhet se asnjë parti nuk i respekton ligjet e tatimit, pasi nuk ua paguajnë tatimet në paga punëtorëve Në Kosovë partitë politike duhet të kenë vetëm një llogari bankare por kanë deri në 20 llogari të tilla. Këtë gjë e ka theksuar përmes një statusi në rrjetin social 'Facebook' edhe Albert Krasniqi nga KDI.

(Gazeta Zëri, 21 dhjetor)

Votuesit në Katalonjë janë drejtuar tek kutitë e votimit në zgjedhjet rajonale të thirrura nga qeveria spanjolle, pas një referendumi kontrovers për pavarësi në këtë pjesë. Zgjedhjet e 21 dhjetorit i ndajnë partitë në ato që e shohin rajonin e pasur si të pavarur nga Spanja, ndaj atyre e duan Katalonjën si pjesë të tyre. Parashikimet e para tregojnë se kandidatët pro-pavarësisë mund të jenë të rezultat në ngushtë me ata që duan unitet me Spanjën. Vëzhguesit presin numër më të madh të votuesve në këto zgjedhje. Në fund të muajit tetor qeveria e Spanjës ka suspenduar autonominë e Katalonjës, shkarkoi qeverinë dhe kërkoi zgjedhje të tjera, pasi separatistët që dominuan parlamentin rajonal shpallën pavarësinë në tetor të këtij viti.

(REL, 21 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

NGA VJEN EMRI POGRADEC?

Invadimi avaro-sllav në shekullin e VII-VIII dhe sidomos perandoria bullgare në shekujt XI-XII ndryshoi mënyrën e jetës në këtë zonë nga ajo "polis" (jetohej brenda mureve të kalave) në atë sedentare fushore duke formuar vendbanime me toponime sllave. Pogradecit do të shkruhet "Pogda grada", që do të thotë "nën qytet". Tashmë qyteti i ri shtrihet nën kalanë e vjetër ilire që është kalaja e Pogradecit. Kalaja e Pogradecit është e vendosur në majën e kodrës, në pjesën perëndimore të qytetit të Pogradecit, me lartësi 205 m mbi nivelin e liqenit të Ohrit. Ka filluar të

banohet që në shekullin V para Krishtit, ndërsa në shekullin IV para Krishtit u pajis me mure mbrojtëse. Ka pasur një vjetërsi banimi prej 1400 vjetësh, duke qenë një kala iliro-shqiptare e hershme. Në gadishullin e Linit mozaikët që datojnë shekullin e VI-VII të magjepsin me bukurinë e tyre, por gojëdhëna për perandorin Justinian të bizantit të shekullit të VI është shumë joshëse. Gojëdhëna thotë: Justiniani, perandori me origjinë ilire, në një moment kritik ka fshehur në brigjet e liqenit të Ohrit në afërsi me gadishullin e Linit një pjesë të rëndësishme të thesarit të perandorisë bizantine. Kjo gojëdhënë ka katërbëdhjetë shekuj që vjen deri në ditët e sotme.



TAKIM I SHKURTËR DHE PA EPILOG



SELA NUK LËSHON PE, TOPI TE ZAEVI

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 21 dhjetor - Pas takimit të shumëpritur me kryeministrin Zoran Zaev, që ndodhi të enjten në mesditë, kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, nuk ka pranuar propozimin që të marrë postin e zëvendëskryeministrit për reforma, duke mos lëshuar pe kështu për ministrin e Shëndetësisë që edhe më tej të udhëheq partia e tij. Sela këtë qëndrim e arsyeoi me faktin se i qëndron besnik marrëveshjes së koalicionit për formimin e Qeverisë. Ndërkohë, gjatë tërë kohës sa mbajti konferencës, ai akuzoi BDI-në si shkaktare të krizës në Qeveri dhe që e ka problematizuar dhe po i bën presion LSDM-së që ASH-së ti merret Shëndetësia. "Opinionin është i informuar në lidhje me një krizë që ekziston në Qeveri, natyrisht sot ishim për të diskutuar këtë temë, ashtu siç ishit të informuar për partnerët e koalicionit. Brenda partnerëve të koalicionit ka një kryetar me flokë të thinjura që mashtron opinionin duke dhënë deklaratatë të tipit që 'nuk janë të kyçur në këtë krizë', ndërkohë që janë ata që e kanë përgatitur këtë krizë realisht. Ne qëndrojmë në qëndrimet tona dhe nuk shohim arsye që të ndryshojmë pozicionin në lidhje me marrëveshjen kur u formua Qeveria. Aleancës për Shqiptarët i takon ministria e Shëndetësisë. Sa kohë kemi udhëhequr në

mënyrë të suksesshme dhe nëse dikujt i pengon suksesi, le të dalë dhe të thotë që i pengon dhe që janë për kaos. Ministri të stisura të tipit 'zëvendëskryeministër për reforma' natyrisht që për ne janë të papranueshme. I dhashë propozim kryeministrit që të emërojë zëvendëskryeministër që të çojë byrek për ministrat dhe atë zëvendëskryeministër do ti japim me kënaqësi BDI-së, sepse dinë ta bëjnë këtë", theksoi Sela. Ai shtoi se për qëndrimet tjera, gazetarët duhet të drejtohen tek kryeministri. Në pyetjen e gazetarëve se a do të thotë kjo se Ali Ahmeti po përkon marrjen Shëndetësisë, Sela tha shkurt se "ai është burim se krizës". Në pyetjen e gazetës KOHA nëse Zaevi kishte qëndrim përfundimtar se ajo do të merr Shëndetësinë pasi që eksponentët të lartë të saj tashmë kanë vendosur për emrin e ministrit të Shëndetësisë, Sela tha se Shëndetësia është problematizuar nga funksionarët e BDI-së gjatë zgjedhjeve lokale dhe se kjo parti po bën presion për lëshimin e këtij dikasteri. "Shiko, Shëndetësia është problematizuar, nëse keni ndjekë deklaratat gjatë periudhës edhe të ciklit të parë dhe të dytë zgjedhor dhe të parët që kanë dhënë deklaratat se Aleanca ka dalë nga Qeveria, kanë qenë Bujari, Artani, ku e di unë kush tjetër, dhe problematizimi i kësaj çështje është bërë nga ata dhe presioni është nga

ata. Të paktën kështu më është kumtuar mua", tha Sela. Në pyetjen tjetër nëse Zaev kishte propozim që LSDM ta merr Shëndetësinë, Sela u përgjigj se Ali Ahmeti është më parë i gatshëm që ministrinë e Shëndetësisë ta merr Zaevi ose LSDM-ja se sa ta mbajë Aleanca për Shqiptarët. "Unë nuk habitem nga kjo qasje, sepse në opinion ka pasur akuza dhe habi se si u humb Spitali i Kumanovës që menaxhohej nga shqiptarë. Të njëjtin qëndrim BDI e ka pasur edhe për Ministrinë e Shëndetësisë, që më mirë ta menaxhojë LSDM se sa ta marrë Aleanca. Kjo është e njëjta logjikë që vepron dhe funksionon akoma në Bashkimin Demokratik për Integritim. Politikisht unë e kuptoj pse e bëjnë këtë. U ka hy tmerri se do ti humbin zgjedhjet, prandaj e kanë këtë qëndrim dhe bëjnë luftën e tyre politike", akuzoi Sela. Ai ishte kritik dhe ndaj deklaratës për opinionin të kryeministrit se Shëndetësia i është dhënë ASH-së për shkak të Arbën Tarvarit, ndërsa Sela tha se Shëndetësia është dhënë për shkak të numrave për të formuar Qeverinë. "Unë kam dëgjuar dhe deklaratat se Ministria e Shëndetësisë është dhënë për shkak të Arben Tarvarit. E vërteta është se Ministria e Shëndetësisë është dhënë për shkak të numrave për të bërë Qeverinë dhe deklaratatë të tilla duhet të jetë e qartë për opinionin se nuk

Pas takimit me kryeministrin Zaev, Ziadin Sela akuzoi BDI-në si shkaktare të krizës në Qeveri dhe që e ka problematizuar dhe po i bën presion LSDM-së që Aleancës për Shqiptarët ti merret Shëndetësia. Për qëndrimin që ASH të mbajë Shëndetësinë, Sela u thirr në marrëveshjen politike për formimin e Qeverisë

mbajnë", deklaroi Sela. Më tej, ai përsëriti qëndrimin se Aleanca nuk do të pranojë post tjetër përveç ministrit të Shëndetësisë. "Ne nuk do të pranojmë pozicionin që merren për një natë për të ulur pozicionin e ASH-së në Qeveri", tha Sela. Ndryshe, sekretari përgjithshëm i LSDM-së, Aleksandër Kiracovski, para takimit Zaev-Sela përsëriti për gazetën KOHA se me Ministrinë e Shëndetësisë do të udhëheq LSDM dhe se partisë së Selës do ti ofrohet vetëm posti i zëvendëskryeministrit për reforma. "Çfarëdo që të ndodh gjatë takimit Zaev-Sela, është definitive se LSDM do të udhëheq me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Aleancës do ti ofrohet vetëm posti i zëvendëskryeministrit për reforma e jo edhe poste tjera, siç është folur për atë të zëvendëskryeministrit të Shëndetësisë", deklaroi Kiracovski.

Gerberich: 2018, vit i rëndësishëm për Ballkanin

Tetovë, 21 dhjetor - Ambasadori i Gjermanisë, Thomas Norbert Gerberich, gjatë qëndrimit në Tetovë tha se, sa i përket integritit të vendit në strukturat euroatlantike, ka theksuar se Maqedonia, por edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor duhet të jenë pjesë e BE-së dhe viti 2018 do të jetë shumë i rëndësishëm për inkorporim në BE. "Sipas mendimit tim, vendi juaj, por edhe të gjithë vendet e Ballkanit perëndimor, duhet që të jenë pjesë e BE-së, kjo çështje është më se e qartë. Mirëpo, për të shkuar në Evropë, duhet të plotësohen disa kushte dhe unë mendoj se qeveria e re ka filluar me energji pozitive t'i plotësojë disa kushte që janë të nevojshme dhe mendoj se i kanë dhënë detyra vetvetes dhe besoj se viti 2018 do të jetë shumë i rëndësishëm për inkorporim në BE. Dhe, nënkuptohet se ne si Qeveri federale, do ta mbështesim edhe me tej qeverinë e re" tha ambasadori gjerman gjatë qëndrimit në kompaninë Vezë Sharri të Tetovës. (U.H)

VMRO refuzoi shtyrjen e Kongresit të jashtëzakonshëm

Shkup, 21 dhjetor - Komiteti ekzekutiv i VMRO-DPMNE-së të mërkurën mbrëma e refuzoi iniciativën e disa funksionarëve aktual dhe të mëparshëm për shtyrjen e Kongresit të jashtëzakonshëm të partisë dhe kjo iniciativë nuk do të gjendet në rend dite të seancës të Komitetit qendror të partisë. KE i VMRO-DPMNE-së e ka shqyrtuar edhe informacionin rreth përgatitjeve për mbajtjen e Kongresit të 16-të të jashtëzakonshëm, që duhet të mbahet më 22 dhe 23 dhjetor në Vallandovë. Shumë anëtarë të VMRO-DPMNE-së, midis të cilëve themelues të partisë, deputetë dhe funksionarë të tjerë, të martën, në prag të Kongresit të partisë, në një letër publike theksuan se favorizohet një kandidat për kryetar të partisë. Ata kërkojnë që në takimet e ardhshme të trupave më të lartë të partisë të pranohen propozimet për rritjen e numrit të delegatëve të cilët do ta zgjedhin njeriun e parë të partisë, si dhe shtyrjen e Kongresit për muajin shkurt të vitit të ardhshëm. KE i VMRO-DPMNE-së ndërkohë i dënoi dhe, siç thuhet në komunikatë drejtuar mediave, "kushtet johumane në të cilat pushteti i mban mbrojtësit e kushtetutës të cilët politikisht janë parabusosur me akuza të montuara për terrorizëm". Komiteti ekzekutiv i dënoi edhe "tentimet e policisë për t'i penguar protestat, me kërcënime dhe provokime, duke tentuar ta shuajë çdo shprehje të pakënaqësisë". KE shqyrtoi dhe miratoi edhe Analizën për zgjedhjet e mbajtura lokale

NUK HIQET DORË NGA ARSIMI I MESËM PROFESIONAL

SHUMË REFORMA PËR PAK NXËNËS

Edhe pse në drejtimet e arsimit profesional trevjeçar regjistrohen çdoherë e më pak nxënës, MASH nuk heq dorë nga investimet në këtë drejtim. Rritja e përfshirjes së nxënësve në arsimin profesional është një prej prioriteteve në shtatë vitet e ardhshme, ndërsa në Strategjinë përkatëse vihet theksi te drejtimet profesionale trevjeçare



kërkesave të tregut, apo "shkollave të zanatit", sikurse quhen ndryshe drejtimet që zgjasin tri vet. Sipas të dhënave të MASH-it, ky lloj shkollimi përbën vetëm 4 për qind të shkollimit të mesëm në Maqedoni. Në vitin shkollor 2016/2017, numri i nxënësve në arsimin e mesëm profesional trevjeçar nuk ishte më i lartë se 3053 nxënës dhe që është 4.1 për qind e numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të po atij viti. Konkretisht, vitin e kaluar shkollor - në të gjitha shkollat e mesme ishin përfshirë 74.684 nxënës, prej të cilëve 30.638 në arsimin e gjimnaz dhe 44.046 nxënës në arsimin e mesëm profesional. Ndërkaq, nga numri i nxënësve në arsimin e mesëm profesional, vetëm 3053 ishin të përfshirë në drejtimet që zgjasin tre vjet, kurse 41.011 në drejtimet që zgjasin katër vjet. Pra, edhe po ta krahasojmë numrin e atyre që vijojnë arsimin profesional trevjeçar me numrin në përgjithësi të arsimit profesional, nuk është e vështirë të shihet se si shkollimi në kohëzgjatje trevjeçare nuk përbën ndonjë përqindje të konsiderueshme. E parë nga ky prizëm, numri i nxënësve në arsimin e mesëm profesional trevjeçar përbën 6.9 për qind të arsimit pro-

fesional në përgjithësi, ndërsa në kuadër të komplet arsimit të mesëm, ai përbën vetëm 4.1 për qind. Por pavarësisht kësaj, përcaktimi i MASH-it është që t'i kushtohet rëndësi këtij shkollimi edhe në të ardhmen. Kjo në mënyrë të qartë është shkruar edhe në Strategjinë Gjithëpërfshirëse të Arsimit për periudhën 2018-2025.

Rritja e përfshirjes së nxënësve në arsimin profesional është një prej prioriteteve të kësaj Strategjie, ndërsa nuk është harruar të vihet theksi te drejtimet trevjeçare. "Që të harmonizohet oferta e arsimit të mesëm profesional me nevojat e tregut të punës, do të vazhdojnë të bëhen përpjekje për përsosjen e mëtejshme të programeve mësimore", qëndron e shkruar aty, ndërsa nënvizohet fati se edhe në të kaluarën janë përgatitur plane dhe programe për reformimin e arsimit të mesëm profesional trevjeçar dhe se paralelisht kësaj - janë trajnuar dhe aftësuar edhe mësimdhënësit për tema si: shfrytëzimi i metodave bashkëkohore, pjesëmarrja aktive e nxënësve dhe nxitja e kreativitetit të tyre, si dhe përsosmëria profesionale e mësimdhënësve. Një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e atyre elementeve, sikurse dihet, ka

dhënë Projekti për modernizimin e sistemit arsimor dhe trajnimit, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Ai projekt u pasua më vonë me Projektin për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacioneve në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar. Me çka "hapet një etapë e re në zhvillimin e arsimit të mesëm në Maqedoni", sikurse vlerësohet në dokumentin e asaj Strategjie.

Por pavarësisht të gjithave, arsimi i mesëm profesional ka në mënyrë permanente problemin e numrit të vogël të nxënësve, në përjashtim të profileve të caktuara të drejtimeve të mjekësisë dhe ekonomisë. Përveç kësaj, nuk është vendosur ende sistemi bashkëkohor i shkollimit post nivelit të arsimit të mesëm dhe janë shumë të limituara kapacitete për sigurimin e inkluziviteti në shkollat e mesme. Një e dhënë tjetër interesante është numri i konsiderueshëm i atyre që pasi kryejnë arsimin e mesëm trevjeçar i kthehen ri shkollimit. Konkretisht, vitin që shkoi ishin 1049 nxënës të cilët kishin regjistruar plotësimin e shkollimit të tyre nga tre në katër vjet, pasi nuk mund ta gjejnë veten në tregun e punës.

Të mbyllet çështja e refugjatëve nga Kosova

Shkup, 21 dhjetor - Plani për kthimin e qytetarëve nga Kosova të cilët ende janë në territorin e Republikës së Maqedonisë si pasojë e konfliktit ushtarak në vitin 1999 ishte temë e takimit të sotëm të ministres së Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska dhe zëvendëskryeministrit kosovar dhe ministër për Komunitete dhe kthim, Dalibor Jevtiq. Në takim, siç kumtuan nga MPPS, ishte shprehur dëshira për mbylljen përfundimtare të kësaj çështje në vitin 2018, për çka janë formuar grupe teknike të cilat punojnë në planin për integrimin dhe kthimin e familjeve dhe tashmë është marrë mbështetje edhe nga UNHCR dhe BE. Në Republikën e Maqedonisë janë rreth 300 persona shtetas kosovar. Gjatë periudhës së kaluar 271 persona kanë shprehur dëshirë dhe janë kthyer në Kosovë, ndërsa për momentin janë 284 persona të cilët janë me status të personave nën mbrojtje subsidiare në RM dhe të për cilët kujdeset shteti. Ministri kosovar Jevtiq informoi se për personat të cilët do të kthehen në Kosovë janë siguruar mjete, si dhe mundësi për punësimin e tyre me qëllim që procesi i kthimit dhe reintegrimit të tyre në Kosovë të jetë i qëndrueshëm. Në takim është hapur edhe çështja për implementimin e Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës për konfirmimin e periudhave të sigurimit që zbatohet prej vitit 2013, si dhe për mundësi të tjera për thellim të bashkëpunimit.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 21 dhjetor - Arsimit të mesëm profesional trevjeçar edhe mund ti ketë humbur vëmendja dhe interesimi nga ana e nxënësve, mirëpo jo edhe nga politikarët arsimorë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) do të vazhdojë të investojë për reformimin e këtij lloj shkollimi, madje duke rritur laramaninë e arsimit profesional edhe me drejtime dyvjeçare. Gjithë kjo, në kuadër të nxitjes dhe mbështetjes së frymës për arsim të përjetshëm dhe orientimit të strategjive arsimore në nivelin e mesëm gjatë shtatë viteve të ardhshme.

Realisht është shumë i vogël numri i nxënësve, të cilët zgjedhin të regjistrojnë shkolla të mesme profesionale në kohëzgjatje prej tre vjet. Shumë pak nxënës regjistrojnë këtë lloj shkollimi pavarësisht stimulimit të vazhdueshëm të politikave për një shkollim sipas

ÇAIRI NËN BRESHËRINË E PLUMBAVE

TRE TË ARRESTUAR PËR VRASJEN E BURIMIT

Shkup, 21 dhjetor - Ngjarjet tragjike në lagjen Çair të Shkupit, nuk kanë të ndalur. Për shumë qytetarë të kësaj ane të Shkupit, skenat e dhunshme, me pasojë fatale, kanë ngjallur një brengë dhe frikë për të ardhmen e tyre dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Vrasja e 24 vjeçarit, Burim Idrizi, pasditën e 20 dhjetorit, ishte incidenti i radhës, kur u përdorën armë zjarri, të shoqëruar me të shtëna nga automatikë. Likuidimi i të riut, sipas dëshmitarëve okularë, i ka ngjarë filmave të dhunshëm, gjegjësisht të shtënat me armë janë

regjistruar në rrugën Xhon Kenedi, pikërisht pranë një stacioni të autobusëve, pjesë kjo e frekuentuar nga një numër i madh qytetarësh dhe posaçërisht nga nxënësit e Shkollës së Mesme "Cvetan Dimov". Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, të enjten ka njoftuar se janë arrestuar tre persona të dyshuar për vrasjen e të djaloshit në Çair. "Jemi duke punuar intensivisht me grupin e Sektorit për Punë të Brendshme - Shkup dhe Prokurorinë. Është gjetur automjeti 'Yugo' prej të cilit është kryer vrasja, si dhe 20 gëzhoja dhe katër

plumba, dy telefona celularë. Bisedime po bëhen edhe me prindërit, miqtë dhe njerëzit të cilët kanë qenë në kontakt me të vrarin", theksoi Spasovski. Sipas tij, pritet gjatë hetimit të mësohen motivet e autorit dhe të sigurohen dëshmi lidhur me autorin. Mes tjerash, ai shtoi se këto raste nuk mund të parandalohen as me praninë e policisë në rrugë. Puna e tyre, theksoi Spasovski, është të jenë ekspeditiv dhe jo selektiv dhe të qasen ndaj të gjitha rasteve në mënyrë efikase për zbulimin e tyre. Kryeshefi i policisë edhe një herë e përsëriti

se policia është duke punuar në zbulimin dhe arrestimin e autorëve për vrasjet të cilat ndodhën muajin e kaluar. Një rrugë më lartë se mbrëmë, kur u vra Burimi, javë më parë, për motive ende të panjohura, me breshëri plumbash u vra Ismet Arifi dhe lëndime të rënda trupore iu shkaktuan shokut të tij, Qemal Lusjani. Ndryshe, sipas njoftimit të deritanishëm nga Prokuroria Publike, vrasjes së 24 vjeçarit, i ka paraprir një zënkë verbale, megjithatë nga prokuroria nuk kanë zbuluar detaje më të hollësishme për këtë ngjarje. (O.XH)



SISTEMATIZIMI I RI I GJYKATËSVE NË GJPSH



NJË GJYKATËS SHQIPTAR TE

KRIMET E RËNDA

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 21 dhjetor - Pjesë e sektorit për krim të organizuar në Gjykatën Penale të Shkupit, me sistematizimin e fundit të gjykatësve, për herë të parë është caktuar një gjykatës shqiptar. Bëhet fjalë për gjykatësin Osman Shabani. Shqyrtimi dhe procedimi i lëndëve të krimit të organizuar dhe korrupsionit në GJPSH paraqet njëherë prej punëve më komplekse sa i përket shpalljes së aktgjykimi. Kësisoj, kryetari i ri i GJPSH, Ivan Xholev, ashtu siç bënte paraardhësit e tij, Vladimir Pançevski, Tatjana Mihajlova e Stojançe Ribarev, së fundmi ua ka ndryshuar vendet e punës gjykatësve brenda sektorëve të gjykatës, të cilën ai e udhëheqë. Publikimi i emrave të gjykatësve të rinj që do t'i gjykojnë lëndët për krim të organizuar, nënkupton se në këtë pozitë janë kthyer gjykatës me përvojë të madhe, të cilët gjatë viteve të kaluar janë izoluar për shkak të partizimit të skajshëm të GJPSH-së. Pas një pauze disa vjeçare, në sektorin për krim të organizuar, nga një janari pritet të ulet gjykatësi Ognen Stavrev, i cili siç tregojnë njohësit e zhvillimeve në Gjykatën Penale të

Shkupit, dy vite më parë, pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm, nga ish-kryetari Pançevski u caktua të punoj në sektorin për kundërvajtje.

Gjatë viteve të kaluar, sistematizimi i gjykatësve në GJPSH, është ndryshuar disa herë, me çka asnjëri prej gjykatësve që punon në këtë instancë gjyqësore, po thuhet nuk ka ngelur pa u prekur nga këto vendime. Megjithatë, nga ajo që mund të veçohet (pavarësisht faktit se gjykatësit shqiptar në GJPSH mund të numërohen në gishta), është se për herë të parë një gjykatës shqiptar vendoset në sektorin më të përfolur, gjegjësisht atë për krim të organizuar.

Gjykatësit të cilët pritet t'i shqyrtojnë lëndët në procedurë paraprake në sektorin për krim të organizuar, sipas këtij sistematizimi, gjatë vitit 2018 (në rast se deri në fund të vitit Gjykata Supreme nuk e refuzohen këtë sistemim), do të jenë gjykatësi Sedat Rexhepagiq, Vesna Dimishkovska dhe Nenad Savevski. Listën e gjykatësve në krim të organizuar, mes tjerash, do ta përbëjnë gjykatësit Vaska Nikollovska-Masevaska, Goran Boshevski (i vetmi i cili nuk është zëvendësuar, gjegjësisht ky gjykatësi ia shpal-

Gjykatësit më të përfolur si lidhja kryesore e VMRO-së me GJPSH-në, me vendimin e fundit të kryetarit Xholev, janë caktuar të procedojnë lëndët në sektorin për kundërvajtje, ndërsa për herë të parë - një gjykatës shqiptar caktohet të gjykojë krimet e rënda

li aktgjykimin me burg të përjetshëm, të akuzuarit Sulejman Osmani, në lëndën e veçuar për Lagjen e Trimave). Tutje, profilin e rëndë të veprave penale do ta procedojnë gjykatësit Sofçe Gavrillovska-Efremova (për momentin e shqyrton rastin kundër gazetarit Dragan Pavloviq-Llatas), Vladimir Tufegxhiq, Dobrinka Kacarska dhe Xheneta Bektoviq.

Nga ana tjetër, gjykatësit më të përfolur deri më tani si lidhja kryesore e VMRO-së me GJPSH-në, me vendimin e fundit të kryetarit Xholev, janë caktuar të procedojnë lëndët në sektorin për kundërvajtje. Ish kryetari i GJPSH, Vlladimir Pançevski, në 2018 do të gjykojë për prishje të rendit publik dhe kundërvajtje në komunikacion, respektivisht gjykatësja Lidija Petrovska (e cila deri më tani është caktuar në një sërë raste të iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike), po ashtu është caktuar në këtë sektor. Veprat për kundërvajtje, me kërkesën e saj, nga vitit i ardhshëm, pritet t'i shqyrtoj edhe gjykatësja më e përfolur gjatë dy viteve të kaluar, Verka Petrovska. Emri i kësaj gjykatëse në opinionin vendas dhe atë të huaj u bë i njohur me shpalljen e dënimeve kapitale për të akuzuarit e "Grupit të Kumanovës. Gjithsej 746 vite burg, 7 dënime me burg të përjetshëm dhe 4 vendime për lirim nga aktakuzë, ishin vendimet, të cilat me 2 nëntor të këtij viti, gjykatësja Verka Petrovska, ua caktoi të akuzuarve për ngjarjet e majit të vitit 2015 në Kumanovë.

"TOPLIKU" SHTYHET PËR MË 30 JANAR

Gjykimi për lëndën e PSP-së "Toplik", në të cilin të dyshuar janë ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, dhe pesë persona për shitjen e parcelës ndërtimore në Sopishte të Shkupit, është shtyrë për më 30 janar të vitit të ardhshëm. Arsyeja për shtyrjen është ajo që dy avokatët e Janakievskit sot janë të angazhuar edhe në rastin "Trust" dhe nuk kanë mundësi të vijnë në gjykimin për "Toplik". Gjykatësja Tatjana Mihajlova, pas debatit midis mbrojtjes dhe prokurorëve rreth termineve për gjykimin, vendosi që seancën e sotme ta caktojë për më 30 janar. Në këtë rast i

dyshuari i parë, si person drejtues në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, në kundërshtim me Ligjin për furnizime publike ka formuar Komision për ankande publike, të cilës i ka urdhëruar të zgjedhë ofrues për blerje dhe disponim me tokën ndërtimore për ndërtim të kompleksit elitari Qyteti i diellit në Sopishte, edhe pse firma nuk i ka plotësuar kushtet për këtë. Nga dëshmitë, sipas PSP, del se për shkak të ndërprerjes së kontratës me fajin e Ministrisë, Ministria është detyruar t'i paguajë në vlerë prej 1 milion eurove borxh dhe interes të parakohshëm personit juridik "San siti".

KRONIKË

Dy të lënduar në shtatë aksidente në Shkup

Dy persona janë lënduar më lehtë në dy prej gjithsej shtatë aksidentëve të regjistruara gjatë ditës së mërkurë në rajonin e SPB Shkup, ndërsa në pesë aksidente është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Njëzetë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, gjashtë shoferë nuk u kanë dhënë përparësi automjeteve në zonën e udhëkryqit dhe shtatë shoferë për rreshtim të gabuar. Nga trafiku janë përjashtuar shtatë shoferë para se të marrin leje për të drejtuar automjetin dhe shtatë automjete të parregjistruara. Janë hasur edhe 82 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special karrotrec janë larguar 80 automjete. Sektori për parandalim do të mbajë masë të veçantë edukimi në të cilën do të marrin pjesë pjesëmarrës në komunikacion, të cilët kanë bërë kundërvajtje në baza të ndryshme në cilësi të shoferit (rreshtim, shpejtësi). E njëjta do të mbahet në hapësirat e SPKP Gazi Babë.

Një grua kafshohet nga një qen në Gjoçe Petrov

Një grua pesëdhjetë e dyvjeçare dje është kafshuar nga një qen në lagjen Gjoçe Petrov të Shkupit. MPB bëri të ditur se R.T. dje pasdite në orën 15:10 derisa ka lëvizur në këmbë nëpër rrugën "Aleksio Demnievski" në Gjoçe Petrov, është sulmuar dhe kafshuar nga një qen. Ndihmë mjekësore i është dhënë në Qendrën Emergjente në Shkup.

Sekuestrohen 80 kg marihuanë në kamionin e një shtetasi të Maqedonisë

Policia serbe në Vlladiçin Han ka sekuestruar rreth 80 kilogramë marihuanë, të fshehur në një kamion me targa të Maqedonisë. Me këtë rast, është arrestuar një shtetas i Maqedonisë 69-vjeçar, kumtoi dje Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë. Në rezervuar dhe në vende të tjera të zbrazëta të kamionit ka pasur 131 pako marihuanë, me peshë të përgjithshme prej rreth 80 kilogramëve. Kundër shoferit I.I. do të ngrihet kallëzim penal për shkak të ekzistimit të dyshimit për vepër të kryer penale, "prodhim i paautorizuar dhe vënie në qarkullim të drogave narkotike". "Marihuanë është zbuluar në kuadër të aktivitetëve të rritura për zbulimin e grupeve kriminale që merren me kontrabandim të narkotikëve, si dhe për prerjen e kanaleve ilegale, thuhet në kumtesë. (O.Xh)

LIGJETË REJA NË KULTURË NË 2018



Pakaja e propozimeve, që janë cilësuar si urgjente nga ministri Allagjozovski, janë vetëm fillimi për ndryshimin rrënjësor që pritet të pësojnë tre ligjet, i Kulturës, Trashëgimisë dhe Filmit, ose zëvendësimi i tyre me ligje krejtësisht të reja

NDRYSHOJNË KRITERET PËR DREJTORËT DHE ARTISTËT

Koha

Evis HALILI

Shkup, 21 dhjetor - Kriteret dhe kushtet për emërimin e drejtorëve në institucionet nacionale të kulturës do të ndryshojnë. Po ashtu, edhe për artistët e kuadrin profesionit në institucione. Ministria e Kulturës ka dorëzuar në Komisionin e Kulturës në Parlament një paketë me propozime, ku ndër të tjera kërkohet që të anulohet kushti për testimin psikologjik dhe integritetit të kandidatit, posedimi i një certifikate për gjuhë të huaj për artistët dhe profesionistët në institucione, kushti për komisione me artistë nga jashtë vendit, e të tjera. Ndryshimet në postet drejtuese në shumë institucione janë paralajmëruar prej kohësh, fillimisht ato u shtynë për shkak të zgjedhjeve lokale, por edhe nga kufizimet ligjore, duke sjellë kështu që numri i drejtorëve provizorë, ose ushtruesve detyre të jetë i madh.

Por, kjo paketë propozimesh që janë cilësuar si urgjente nga ministri Allagjozovski janë vetëm fillimi për ndryshimin rrënjësor që pritet të pësojnë tre ligjet, të Kulturës, Trashëgimisë dhe Filmit, ose zëvendësimi i tyre me ligje krejtësisht të reja. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë e rishikimit të tyre me themel gjatë vitit të ardhshëm, pasi një gjë e tillë po kërkohet nga ekspertët e kësaj fushe.

"Të tre këto ligje ekziston mundësia që të hapen për t'u diskutuar në debat publik gjatë vitit të ardhshëm dhe të miratojmë ligje krejtësisht të reja të cilat do t'i tejkalojnë mangësitë e akumuluar të këtyre ligjeve, të cilat kryesisht janë miratuar me procedura të përsheptuara dhe në



Në Ligjin e Kulturës kërkohet të anulohet kriteri që i obligon artistët, ose stafin artistik, apo profesionist të një institucioni që të posedojnë certifikata për njohjen e gjuhëve të huaja, pasi një gjë e tillë nuk jep asnjë kontribut pozitiv në profesionalizmin e artistit

mungesë të një debati të vërtetë", ka thënë ministri në Komisionin e Kulturës.

Sa i takon kushteve për emërimin e drejtorëve, përfshirë edhe atë të Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë dhe Agjencisë së Filmit, me ndryshimet e propozuara do të duhet që kandidatit

krahas certifikatave të tjera të posedojë APTS për posedimin e gjuhës angleze, si një vërtetim me kosto ekonomike dhe po aq valid sa të tjerët. Po ashtu është kërkuar që kandidatët për drejtorë të mos i nënshtrohen testit për integritet dhe atij psikologjik, për shkak se janë dëshmi shumë formale dhe realisht askush nuk mund t'i sigurojë.

Sa i takon drejtorit të Agjencisë së Filmit Ministria e Kulturës kërkon që të ndryshohet Ligji për veprimtarinë filmike, përkatësisht të reduktohet koha që i lihet në dispozicion drejtorit për të korrigjuar gabimet e konstatuara. Nëse nuk eliminohen për gjatë muaj, ai do të shkarkohet nga detyra.

Në Ligjin e Kulturës kërkohet të anulohet kriteri që i obligon artistët, ose stafin artistik, apo profesionist të një institucioni që të posedojnë certifikata për njohjen e gjuhëve të huaja, pasi një gjë e tillë nuk jep asnjë kontribut pozitiv në profesionalizmin

e artistit. Edhe përbërja e komisioneve me pesë anëtarë që vendosin për punësimet e artistëve në institucione do të ndryshojnë. Nëse më parë kërkohej që katër nga pesë anëtarët të ishin nga jashtë vendit, Ministria e Kulturës e tërheq domosdoshmërinë e përbërjes së këtij komisioni.

"Propozohet që jo domosdoshmërisht të kenë katër anëtarë nga jashtë, pasi angazhimi i artistëve të huaj për çdo procedurë punësimi me audicion dhe për procedurën e reaudicionit është treguar në praktikë si e ndërlikuar dhe me faturë të lartë financiare për institucionet. Propozohet që jo gjithmonë të jenë të detyruar që të angazhohen anëtarë nga jashtë vendit, por jo edhe në rast nevojë, kur bëhet fjalë për kuadër artistik deficitar", thuhet në paketën e propozimeve. Si pjesë e ndryshimeve, është edhe afati kohor për marrjen e titullit këshilltar i bashkëpunëtorëve profesionistë, që nga gjatë vjet bëhet në tetë vjet.

STRATEGJI PLOTËSUESE PËR TURIZMIN

Panel diskutimi i parë me temë ndryshimi dhe plotësimi i legjislationit i cili u zhvillua sot në kuadër të Konferencës "Zhvillimi i turizmit në vend", u organizua nga Ministria e Ekonomisë, të cilën e drejtoi shefi i departamentit të Turizmit dhe Hotelierisë, Bekim Haxhiu. Një grup pune i përbërë prej përfaqësuesve të Ministrisë së Ekonomisë, pushtetit vendor, rajoneve planifikuese Fakultetet e Turizmit dhe hotelierisë, Inspektoratit Shtetëror të Tregut, dhomat tregtare dhe sektorit privat do të definojnë ndryshimet në legjislationin për turizëm dhe hotelieri. "Propozimet e komunitetit të biznesit sipas ligjit për aktivitete turizmi përfshijnë kufizimin e validitetit të licencave turistike për tre vjet, mundësinë e aplikimit për një licence të re të operatorit turistik, rregullimin e

aranzhimeve, licenca për udhëzues turistik me kohëzgjatje, forcimin e kontrolleve për agjencitë e paregjistruara dhe udhëzuesit për të parandaluar konkurrencën jolojale", thuhet në kumtesën e Ministrisë së Ekonomisë. Sa i përket Ligjit për veprimtari hotelierike propozohen ndryshime në rregullat për kategorizimin në drejtim të shërbimeve për vlerësim, kategorizimin e të gjitha objekteve hotelierike për akomodim dhe ushqim me rregullore të veçanta për kushtet, duke përfshirë forma të reja të cilat nuk janë përfshirë deri tani, rregullimi i shitjeve përmes online operatorëve, rregullimi i sistemit elektronik për paraqitjen e turistëve, rregullimin e tarifës për qëndrim të përkohshëm, kontroll të zgjeruar të restoranteve të paregjistruara etj.

KRONIKË

Gjendet e vdekur plaka 77 vjeçare

Të mërkurën, rreth orës 17.00, nga të punësuar në spitalin klinik të Tetovës, është denoncuar se në një shtëpi që gjendet në rrugën "134", në Tetovë është gjetur e vdekur 77-vjeçarja me iniciale S.J. Prokurori publik, një ekip i sektorit për punë të brendshme në Tetovës si dhe një mjek nga mjekësia ligjore, kanë kryer ekspertizë dhe pas kontrollit mbi trupin e pajetë të S.J nuk janë gjetur shenja dhune. Me urdhër të prokurorit publik, trupi i pajetë i S.J, e cila ka jetuar e vetme në shtëpi, i është dorëzuar familjes.

Mbyllet edhe një bastore

Të mërkurën, në mes orës 12.30 minuta dhe orës 14.00, është kryer kontroll në dy bastore sportive, të lokalizuara në qendër të fshatit Rostushë. Pas kontrollit është vërtetuar se bastorja "Free Time bett" ka punuar ilegalisht, pa licencën e nevojshme, dhe për këtë shkak nga i punësuar i 26-vjeçari me iniciale S.A, i cili është gjendur në objekt gjatë kontrollit të kryer, janë konfiskuar: 3 televizorë, 2 shtëpiza kompjuterike, pajisje të ndryshme të kompjuterëve si dhe para në vlerë prej 3500 denarë. Po punohet në zbardhjen e plotë të të gjitha detajeve që ndërliken me punën e kësaj bastore, pas çka do të pasoj padit adekuate.

Aksident me dy të lënduar

Në rrugën lokale në Çellopek, të mërkurën, rreth orës 12.30 minuta, ka ndodhur një aksident komunikacioni, në të cilin janë përfshirë dy automjete me targa të Tetovës, edhe atë një veturë e tipit "Ford Tranzit", e drejtuar nga 39-vjeçari me iniciale N.Z nga Çellopeku, si dhe një "Ford Fiesta:", të cilën e ka drejtuar 28-vjeçari me iniciale B.F nga i njëjti fshat. Në këtë aksident një bashkudhëtarë minoren që është gjendur në veturën e tipit "Ford Fiesta", i moshës 2-vjeçare për pasojë ka përfunduar me lëndime më të rënda trupore, ndërsa bashkudhëtarit i dytë, i moshës 17-vjeçare, ka marrë lëndime më të lehta trupore. Të lënduarit në këtë aksident janë dërguar në spitalin klinik të Tetovës, nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas të dhënave fillestare që bazohen në ekspertizën e kryer në teren nga pjesëtarë të policisë së Sektorit për punë të brendshme, si shkak për këtë aksident është parakalimi i parregullt, përderisa dëmi i shkakuar material vlerësohet që të jetë rreth 50 mijë denarë. (U.H)

BORXHI SHETËTOR

400 MIJË EURO KAMATA DITORE!

Ekonomistët thonë se me rritjen ekonomike modeste prej vetëm disa për qind në vit në periudhën e kaluar, Maqedonia ka vështirësi jo vetëm të paguajë borxhin kryesor por edhe kamatat, pa hyrë në borxhe të reja brenda apo jashtë shtetit

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 21 dhjetor - Maqedonia në periudhën 2012-2017 ka paguar mbi 500 milionë euro vetëm për kamatat e borxhit shtetëror. Të dhënat zyrtare tregojnë se në periudhën janar i vitit 2012 deri në muajin tetor të 2017-ës, për kamata janë paguar afër 560 milionë euro. Përlllogaritjet tregojnë se në mesatare, për çdo ditë, në emër të kamatave, paguajnë afër 406 mijë euro, nëse përlllogarim borxhin prej 122 milionë të kamatave që është paguar përgjatë

periudhës janar-tetor të këtij viti. Bile, të dhënat tregojnë se kemi dyfishim të shumës që paguajmë në emër të kamatave të borxhit të shtetit në dhjetë vitet e fundit. Analizat tregojnë se në vitin 2006, për kamata kemi paguar 51 milionë euro në vit, ndërsa vetëm në dhjetë muajt e parë të këtij viti, për kamatat e borxheve janë paguar 122 milionë euro. Ekonomistët thonë se me rritjen ekonomike modeste prej vetëm disa për qind në vit në periudhën e kaluar, Maqedonia ka vështirësi jo vetëm të paguajë borxhin kryesor, por edhe kamatat, pa hyrë në borxhe të reja brenda apo jashtë shtetit.

Vlerësohet se rritja modeste prej 2-3 për qind në vitet e kaluara, apo në të holla prej 180 deri 270 milionë euro vështirë se i mbulon kamatat në vlerë prej 100 milionë euro në vit, dhe pagesën e borxhit kryesor, që vetëm në vitin 2017, është i vlefshëm 507 milionë euro. Hyrja e mëtejshme në borxh imponohet edhe me deficitin buxhetor prej 3 për qind të PBB-së apo afër 270 milionë euro në vit. Në vitet e kaluara, huazimet, së bashku me kamatat, pak

kanë mbështetur rritjen ekonomike më të madhe dhe nuk kanë përmirësuar standardin e qytetarëve, për shkak se janë harxhuar në një pjesë të madhe në mënyrë joproduktive dhe kanë shkuar edhe për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse të funksionimit të shtetit. Borxhi publik që në Maqedoni varet nga rritja ekonomike, deficitin primar dhe cilësia e shpenzimeve publike apo mënyra e harximit të të hollave. Nga ana tjetër, viteve të fundit, strukturat e shpenzimeve që identifikojnë rritjen, tregojnë se struktura e shpenzimeve ka qenë për qëllime më shumë joproduktive sesa produktive, tregojnë analizat e Qendrës për analiza ekonomike. Themelorja është gjatë rritjes së borxhit publik, a është rritur në të njëjtën kohë edhe Prodhimi i Brendshëm Bruto, kur dihet se kohët e fundit në Maqedoni, PBB e jonë shënon stagnim, ndërsa kemi rritje të borxhit publik.

Njohësit e financave vlerësojnë se nuk është problem edhe nëse Maqedonia futet në borxh publik, por vetëm me një dinamikë të kujdesshme dhe me investime kapitale në infrastrukturë, arsim, shën-

detësi, zvogëlim të varfërisë dhe të ngjashme, me çka borxhi mund të jetë edhe produktiv pasi këto të holla shkojnë në harxhim të pastër dhe nuk ndihmojnë rritjen e aktiviteteve ekonomike. Problem tjetër i financave të shtetit në vend, është edhe gjendja kur shteti ka harxhime më të mëdha se të ardhura, andaj edhe në fund të çdo viti vjen te deficitin buxhetor që sjell edhe rritjen e borxhit të shtetit, që mbulohet me huazime të reja në vend të rritjes së shëndoshë ekonomike.

Ndryshe, në vitin 2012 borxhi publik ka qenë 2.908 miliardë euro, ndërsa kamatat kanë qenë 69 milionë euro, në vitin 2013 borxhi publik ka qenë 3.281 miliardë euro, ndërsa kamatat kanë qenë 75 milionë euro. Në vitin 2014 borxhi publik ka qenë 3.921 miliardë euro, ndërsa kamatat kanë qenë 83 milionë euro, në vitin 2015 borxhi publik ka qenë 4.227 miliardë euro, ndërsa kamatat kanë qenë 105 milionë euro. Ndërsa në vitin 2016 borxhi publik ka qenë 4.71 miliardë euro, ndërsa kamatat 117 milionë euro.

Më pak transparent e ministritë që kanë shpenzuar më shumë

Shkup, 21 dhjetor - Ministria e Punëve të Brendshme, e Shëndetësisë, e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, si dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës kanë qenë më jotransparente në procesin e furnizimeve publike. Këtë e tregon analiza për matjen e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në furnizimet publike e realizuar nga Qendra për komunikime qytetare për furnizime të realizuara publike gjatë vitit 2016. Sipas hulumtimit, katër institucionet më ulët të ranguar shpenzojnë pjesën më të madhe të të hollave për furnizime publike, gjegjësisht 75 për qind nga mjetet e përgjithshme që i kanë shpenzuar institucionet e përfshira. Derisa shtatë institucionet me përmbushje më të lartë të përqindjes shpenzojnë vetëm pesë për qind nga mjetet e përgjithshme për furnizime publike. Janë analizuar 21 institucione të cilët kanë treguar nivel të mesëm të transparencës. "Institucionet janë ranguar në pesë nivele. Në nivel të ulët dhe më të lartë nuk ka asnjë institucion që do të thotë se asnjë institucion nuk realizon nga 80 deri në 100 për qind përmbushje të kriterëve, as madje nuk ka ndonjë që i ka nga 0 deri deri në 20 për qind. Të gjithë janë në nivel të mesëm nga 20 deri në 80 për qind. Më shumë institucione ka në nivelin e kufizuar, gjegjësisht nga 40 deri në 60 për qind përmbushje të kriterëve për transparencë të furnizimeve publike", deklaroi German Fillkov nga Qendra në prezantimin e sotëm të analizave. Sipas hulumtimit, asnjë institucion nuk e ka respektuar kriterin për vlerësimin e bërë për nevojën për furnizim dhe kontrollin dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve. Me analizën janë përfshirë ministritë, Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkët, Sekretariatet për legjislacion, për zbatim të Marrëveshjes së Ohrit, për Çështje Evropiane dhe Kuvendi i RM-së.

Ndalohej ushqimi për foshnje "Laktalis"

Shkup, 21 dhjetor - Tërhiqen ushqimi për foshnjat me emrin tregtar Picot SL dhe prodhimet nga brendi Picot SL Celia Prema, Celia Digex - 12, Celia Expert 2 me numra serik 17 0013095; 17 0012806 dhe 170012838 me prejardhje nga Franca, nga fabrika "Laktalis", kumtoi Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (AUV). Sipas AUV, konsumatorët të cilët tashmë i kanë blerë këto produkte nuk duhet t'i konsumojnë dhe mund t'i kthejnë në vendin ku i kanë blerë. Prodhimet janë importuar në Maqedoni përmes Promedika SHPKNJN nga Shkupi. Informata se prodhimet janë jo të sigurta është marrë përmes sistemit RASFF të BE-së për informim të shpejtë.

Nuk ndryshojnë rregullat për punë në Gjermani

Tetovë, 21 dhjetor - Ambasadori gjerman në Maqedoni, Thomas Norbert Gerberich, ka përgënjeshtruar lajmin që është shpërndarë në disa media online kinse qytetarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, nga 1 janari i vitit 2018 do të mundën të punojnë në mënyrë legale në Gjermani vetëm me dokumente të shteteve të tyre, respektivisht pa pasur një pasaportë apo dokumente të njërit nga shtetet anëtare të BE-së. E vërteta është se shtetasit e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Gjermani, mund të punojnë vetëm me një vizë pune që jepet pas një kontrate dhe leje pune. "Po është e vërtetë se qarkulloi një informacion në media se shtetasit e shteteve të Ballkanit Perëndimor, që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian, nga viti 2018 do të mund të punojnë në Gjermani me dokumente të shteteve të tyre njëjtë sikur shtetasit e shteteve që janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Mirëpo, në këtë pikëpamje, mund t'ju them se ky lajm është vetëm një spekulim dhe nuk ka asgjë të vërtetë",

tha ambasadori gjerman Thomas Nobert Gerberich, i cili gjatë ditës së enjte ka qëndruar në kompaninë Vezë Sharri, ku pati mundësi që më për së afërmi të njihet me procesin e prodhimit të kësaj kompanie. "Pashë që kjo kompani punën e bën në mënyrë shembullore dhe lirshëm mund t'ju them se këtu jam ndjerë sikur të isha në Gjermani. Në Maqedoni funksionojnë mbi 200 ndërmarrje gjermane, kurse kompania që vizitua sot, është një ndër kompanitë më të mira dhe shembullore dhe unë uroj që të ketë sa më shumë kompani si kjo. Më lejoni të theksoj edhe një diçka shumë të rëndësishme, kompanitë si Vezë Sharri janë të rëndësishme që njerëzit të mbeten këtu, sepse unë për çdo ditë përpara ambasadës shoh turma njerëzish që kërkojnë një vizë për të shkuar dhe punuar në Gjermani dhe qëllimi është që ata njerëz të ngelin këtu dhe të punojnë për vendin e tyre e jo ta lëshojnë atë", tha ambasadori gjerman Thomas Nobert Gerberich. (u.h)

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 167/15), në pajtim me Pëlqimin për financim të vjetër për vitin shkollor 2017/2018 me numër 12-11025/3 të datës 12.12.2017 të marrë nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë së Sektori për arsim fillor dhe të mesëm, ndërsa në kuptim të Nenit 60, paragrafi (2) të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 i 135/14, 10/15, 98/15, 30/16, 127/16, 67/17), dhe Vendimit nga data 13.12.2017 për publikim të shpalljes publike për punësim të mësimdhënësve për kohë të caktuar të punës – financim i vjetër deri më datën 31.08.2018, Drejtori i Shkollës së mesme të Qytetit të Shkupit "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional për kohë të caktuar të punës – financim i vjetër deri më 31.08.2018 për vendet e punës në vijim:

PUBLIKOHET, shpallje publike për punësim të mësimdhënësve për kohë të caktuar të punës – financim i vjetër deri më 31.08.2018 për vendet e punës në vijim:

MËSIMI NË GJUHËN MAQEDONASE

1. Mësimdhënës të gjuhës maqedonase, me 11 (njëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 22 (njëzetdy) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me fakulltet të mbaruar filologjik, profesor i diplomuar i gjuhës maqedonase, të shpërndarë në 3 (tre) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 11.837,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

2. Mësimdhënës të gjuhës angleze, me 5 (pesë) orë mësimore, gjegjësisht 10 (dhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me fakulltet të mbaruar filologjik, profesor i diplomuar i gjuhës angleze, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 5.380,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

3. Mësimdhënës të fizikës, me 10 (dhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 20 (njëzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për fizikë, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 10.761,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

4. Mësimdhënës të historisë, me 3 (tri) orë mësimore, gjegjësisht 6 (gjashtë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për histori, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 3.228,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

5. Mësimdhënës të pedagogjisë, me 6 (gjashtë) orë mësimore, gjegjësisht 12 (dymbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për pedagogji, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 10.761,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

6. Mësimdhënës të hyrjes në drejtësi, me 6 (gjashtë) orë mësimore, gjegjësisht 12 (dymbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për drejtësi, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 6.457,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

7. Mësimdhënës të biznesit me 6 (gjashtë) orë mësimore, gjegjësisht 12 (dymbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me fakulltet të mbaruar ekonomik, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 6.457,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

8. Mësimdhënës të biznesit me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me fakulltet të mbaruar ekonomik, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

9. Mësimdhënës të psikologjisë, me 10 (dhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 20 (njëzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për psikologji, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 10.761,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

10. Mësimdhënës të informatikës, me 2 (dy) orë mësimore, gjegjësisht 4 (katër) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për informatikë, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 2.152,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

11. Mësimdhënës të sportit dhe aktiviteteve sportive, me 10 (dhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 20 (njëzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për edukatë fizike, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 10.761,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

12. Mësimdhënës të sportit dhe aktiviteteve sportive, me 6 (gjashtë) orë mësimore, gjegjësisht 12 (dymbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për edukatë fizike, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 6.457,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

13. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 2 (dy) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

14. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 8 (tetë) orë mësimore, gjegjësisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të

mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 8.609,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

15. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për arkitekturë, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 4 (katër) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për arkitekturë, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

16. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për arkitekturë, me 11 (njëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 22 (njëzetdy) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për arkitekturë, të shpërndarë në 3 (tre) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 11.837,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

17. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për arkitekturë, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 4 (katër) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për arkitekturë, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

18. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për gjeodezi, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 5 (pesë) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për gjeodezi, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

19. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për gjeodezi, me 15 (pesëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 30 (tridhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për gjeodezi, të shpërndarë në 4 (katër) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 16.144,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

20. Mësimdhënës të mësimin praktik të drejtimit të ndërrimtarisë 30 (tridhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me arsim spjator, të lartë ose speciale me përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore prej 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

MËSIMI NË GJUHËN SHOJPE

21. Mësimdhënës të artit figurativ, me 9 (nëntë) orë mësimore, gjegjësisht 18 (tetëmbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për art figurativ, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 9.685,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

22. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

23. Mësimdhënës të gjuhës shqipe, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me fakulltet të mbaruar filologjik, profesor i diplomuar i gjuhës shqipe, të shpërndarë në 4 (katër) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

24. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 36 (tridhjetëgjashtë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 19.370,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

25. Mësimdhënës të gjuhës angleze, me 14 (katërmëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 28 (njëzetetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me fakulltet të mbaruar filologjik, profesor i diplomuar i gjuhës angleze, të shpërndarë në 3 (tre) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 5.380,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

26. Mësimdhënës të matematikës, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 2 (dy) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për matematikë, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

27. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për gjeodezi, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për gjeodezi, të

shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

28. Mësimdhënës të lëndëve profesionale arkitektonike, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 3 (tre) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për arkitekturë, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

29. Mësimdhënës të sportit dhe aktiviteteve sportive, me 20 (njëzet) orë mësimore, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për sport, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 21.522,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

30. Mësimdhënës të kimisë, me 3 (tre) orë mësimore, gjegjësisht 6 (gjashtë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për kimi, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 3.228,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

31. Mësimdhënës të biologjisë, me 4 (katër) orë mësimore, gjegjësisht 8 (tetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për biologji, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 4.304,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

32. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 17 (shtatëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 34 (tridhjetekatër) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 4 (katër) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 18.294,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

33. Mësimdhënës të fizikës, me 8 (tetë) orë mësimore, gjegjësisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për fizikë, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 8.609,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

34. Mësimdhënës të geografisë, me 4 (katër) orë mësimore, gjegjësisht 4 (katër) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për gjeografi, të shpërndarë në 1 (një) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 2.152,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

35. Mësimdhënës të filozofisë, me 10 (dhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 20 (njëzet) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për filozofi, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 10.761,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

36. Mësimdhënës të lëndëve profesionale për ndërrimtarin, me 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore, gjegjësisht 36 (tridhjetëgjashtë) orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për ndërrimtarin, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore 19.370,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, me orar të punës me dy ndërrime – ndërrimi i parë prej ora 08.00 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e caktuara në dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim të mesëm edhe atë:

- Të kenë arsim përkatës në pajtim me normativin për kuadër mësor për vendin e nevojshëm të punës;
 - Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.
- Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të paraqesin dokumentet në vijim:
- Diplomë ose Certificatë për arsimin e mbaruar përkatës;
 - Certificatë për derikualifikim pedagogjik-psikologjik dhe metodik (për mësimdhënësit që nuk kanë mbaruar grup mësor të studimeve);
 - Certificatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.
- Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat vërsënitë nga kandidatët e paraqitur, në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167 / 2015). Punëtorët e pranuar në lidhje me shpalljen publike do të ndërrojnë ndërrimet çdo dy javë.
- Të gjitha dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, të parashirohen deri në Shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, bulevardi "Partizanski Odred" nr. 91, 1000 Shkup përmes postës rekomanduese ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës. Dokumentet e pakompletuara, të parregulluara dhe të dorëzuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit nga ana e Komisionit.
- Personat për kontakt në lidhje me shpalljen publike janë Vera Hristovska me kontakt telefon 02/3062-694 dhe kontakt e-mail adresë kontakt@zdravkocvetkovski.gov.mk

Shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit "Zdravko Cvetkovski" – Shkup DREJTOR, Dragica Kostadinovska

SHFK "Bratstvo-Edinstvo" – Dibir Nr. 04-292/2 të datës 20.12.2017

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 158/2010) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008) dhe Pëlqimit të Ministrisë së arsimit dhe shkencës nr. 12-11109/3 të datës 11.12.2017, SHFK "Bratstvo-Edinstvo" – Dibir, publikon

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018

- Një mësimdhënës të historisë për 12 orë mësimore, mësimi në gjuhën shqipe, deri më 31.08.2018 me neto pagesë prej 12.384 den. Orari i punës prej ora 07:30 -13:00 ose prej ora 13:00 -18:30; (zëvendësim për drejtorin);
- Një mësimdhënës të arsimit qytetar për 8 orë mësimore, mësimi në gjuhën shqipe, deri më 31.08.2016 me neto pagesë prej 8.256 den. Orari i punës prej ora 07:30 -13:00 ose prej ora 13:00 -18:30; (zëvendësim për drejtorin);
- Një mësimdhënës të geografisë për 16 orë mësimore, mësimi në gjuhën maqedonase, deri më 31.08.2016 me neto pagesë prej 16.512 den. Orari i punës prej ora 07:30 -13:00 ose prej ora 13:00 -18:30 (zëvendësim të ndihmës drejtorit);

KËRKOHET NDIHMË NGA PUSHTETI QENDROR



MBETJET NGA VËRSHIMET “PUSHOJNË” NË TEARCË

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 21 dhjetor - Komuna e Tearcës tashmë ka dërguar shkresë zyrtare te pushteti qendror që të përkrahë këtë komunë për të rregulluar mbetjet nga përmbytjet, që u shkaktuan nga Lumi i fshatit Poroj, të cilët ishin deponuar në territorin e Komunës së Tearcës. Deri më tash përgjigje nuk ka nga Qeveria dhe Ministria e Ekologjisë, që të ndajë naftë të nevojshme që Komuna e Tearcës të pastrojë këto mbetje, kurse kryetari i Komunës së Tearcës, Isen Asani, thotë se nëse pushteti qendror nuk gjen zgjidhje tash, atëherë në të ardhmen do të ndalohet hedhja e mbetjeve në atarin e Komunës së Tearcës.

Ai shprehet se me këtë problem do të merret edhe Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim. “Ne jemi drejtuar me kërkesë Qeverisë dhe Ministrisë së Ekologjisë dhe kemi marrë përgjigje se me këtë

çështje do të merret Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim dhe ne kemi kërkuar që të ndahen 10 tonë naftë, sepse si komunë nuk kemi kapacitet që të bëjnë nivelizimin e deponisë. Nëse nuk kemi përgjigje, atëherë do të mendohe mi që me kompanitë tonë të bëjmë diçka dhe kjo do të jetë në koordinim me bashkësitë lokale”, tha Asani.

Ai më tej ka nënvizuar se ka marrë garanci nga ish ministri i Ekologjisë, Nurhan Izairi, që pas stabilizimit të gjendjes do të intervenohet, por nuk ka asnjë përgjigje në këtë drejtim. “Sa i përket çështjes së deponive në nivel të rajonit të Pollogut, të krijuara në mënyrë të egër, të themi kushtimisht, ne mbajmë përgjegjësi për të gjithë rajonin, të gjithë kryetarët e komunave njëkohësisht edhe për deponinë regjionale deponinë Rusino, do të fokusohem në problemin që ne e kemi si komunë, deponia e cila u krijua nga vërshimet që

ndodhën edhe këtë vit dhe para dy viteve, konkretisht në fshatin Glllogjë dhe Dobrosht, para dy javëve kemi adresuar kërkesë për sanimin e deponisë të krijuar nga material që është sjellë prej shtretërve të dy lumenjve në fshatin Poroj dhe në fshatin Poroj dhe Dobrosht, pasi që trupi koordinativ në atë kohë dha garancë me ish ministrin Nurhan Izairi, se ne, pas përfundimit të punëve, do të bëjmë nivelizim, ndërsa një gjë e tillë nuk ka ndodhur”, tha kreu i Komunës së Tearcës, Isen Asani.

Ministri i Pushtetit Lokal, Suhejl Fazliu, sqaroi se kjo çështje tashmë diskutohet në nivel qendror. “Mund t’ju them se çështja e deponive tanimë ka kaluar si temë në nivel të qeverisë ku qeveria realisht merret me gjetjen e një zgjidhje përfundimtare për deponitë në nivel nacional. Ne jemi të mendimit se kjo çështje duhet të elaborohet mirë dhe të shihet edhe një herë se a është kapacite-

Vërshimet në muajin qershor sollën tonelata mbetje në Lumin e Porojit, kurse si lokacione për të transportuar këto mbetje, ishte caktuar një vend që ndodhet në mes fshatrave Glllogjë dhe Dobrosht, ku akoma këto mbetje janë të panivelizuara

ti i duhur i rajoneve për ta zgjidhur këtë apo ky obligim do të duhet të merret më seriozisht në nivel nacional dhe të kalojë në kompetencë të pushtetit qendror, që përfundimisht ta marrin në mënyrë serioze dhe të gjejnë një zgjidhje”, tha ministri Fazliu. Përndryshe, vërshimet në muajin qershor sollën tonelata mbetje në Lumin e Porojit, kurse si lokacione për të transportuar këto mbetje ishte caktuar një vend që ndodhet në mes fshatrave Glllogjë dhe Dobrosht, ku akoma këta mbetjet janë të panivelizuara dhe të njëjtat janë shumë afër këtyre dy vendbanimeve dhe përreth ka edhe shtëpi banimi të cilët përballen me erë të pakëndshme gjatë tërës kohës dhe drujnë për përhapje të ndonjë epidemie.

Promovohen librat e Xhelal Nezirit dhe Bardhyl Zaimit

Tetovë, 21 dhjetor - Në Tetovë, në Qendrën “Loja”, janë promovuar dy libra të autorëve Xhelal Nezirit dhe Bardhyl Zaimi. Libri i parë që u promovua ka qenë “Kohët e Eklipsit” të gazetarit Xhelal Neziri, që është një kronikë mbi realitetin politik shqiptar. “Në këtë libër ka shumë të pathëna, intervista të pabotuara, biseda që dalin për herë të parë në publik dhe shkrime publicistike mbi momentet e eklipsuara të historisë sonë të re. E vërteta mbi identitet kolektive, manipulimin, patriotizmin dhe hajninë. Këto janë munduar që t’i përmbledh në këtë libër, me të cilin lexuesi nuk mendoj se duhet të pajtohet dhe të hapet debat”, tha Neziri. Për recensentin e këtij libri, Daut Dauti, ky libër analizon me detaje dhe profesionalizëm zhvillimet politike në Maqedoni. Sipas tij, libri ndër lidhet me mjeshtëri me zhvillimet politike në Kosovë dhe Shqipëri që kanë pasur ndikimin e tyre tek shqiptarët e Maqedonisë. Në ndërkohë po ashtu është promovuar libri poetik i publicistit Bardhyl Zaimi, i titulluar “Dorëshkrime prej ajri”. Poezitë në këtë libër, sipas Zaimit, janë dorëshkrime nga kohë të ndryshme. Përndryshe, sipas promotorëve të këtij libri, Qendra Loja, është e hapur për të gjithë ata që kanë nevojë të bëjnë promovojnë libra dhe aktivitete tjera. (u.h.)

APEL PËR ATA QË SHKOJNË NË KODRËN E DIELLIT

Tetovë, 21 dhjetor - Në qendrën rekreative dimërore “Kodra e Diellit” në këtë dhe veçanërisht në vikendin e ardhshëm, pritet që të fillojë sezoni i ri turistik, pas çka dukshëm do të rritet dinamika e automjeteve dhe njerëzve, në veçanti gjatë vikendeve, kur kjo qendër rekreative dimërore më shumë vizitohet nga mysafirë, të apasionuar pas sporteve dimërore. Për të shmangur aksidente më të mëdha të komunikacionit si dhe probleme të padëshiruara të natyrës së sigurisë, Sektori për punë të brendshme në Tetovë apelon deri të pronarët e automjeteve motorike që në tërësi të respektojnë regjimin e vendosur për lëvizje dhe parkim si dhe urdhrat e pjesëtarëve të policisë. Ata të



cilët në Kodrën e Diellit planifikojnë që të shkojnë me automjete gjithashtu këshillohen, që automjetet e tyre t’i mbyllin mirë dhe

në të mos lënë gjësende me vlerë, si çanta, telefona celularë, syza dielli, lap top dhe të ngjashme. Vozitësit rikujtohen për obligimet

ligjore që kanë për mbajtjen e pajisjeve dimërore dhe me përgjegjësi të sillen kundrejt pastërtisë publike, gjegjësisht të mos i hedhin mbetu-

rina vend e pa vend, por në vende dhe kosha të përshtatshëm për mbeturinat. Pronarët e sajave motorikë sërish sugjerohen që të mos lëvizin me sajat e tyre në pistat e skijimit, për shkak se me saja motorikë në pistat e skijimit vënë në pikëpyetje sigurinë personale, por edhe personave të tjerë të pranishëm në shtigjet skijimit. Në këtë muaj, por edhe në dy tre muajt e ardhshëm, Sektori për punë të brendshme në Tetovë, do t’i përforcojë aktivitetet e planifikuara preventive në Kodrën e Diellit, me qëllim që shpejtë të zbulojë dhe mënjanojë të gjitha ato lëshime dhe mangësi të sigurisë dhe natyrate të tjera si dhe në mënyrë adekuate të sanksionojë kundërvajtësit.

Në kërthizë të Shqipërisë, ndodhi hataja!



Nga Fadil LUSHI

Sikur sot t'i pyesësh historianët se çfarë është dallimi mes politikanëve të dikurshëm shqiptarë me këta të sodit, do të thonë se dallimi është shumë i vockël. Thjesht, nuk hetohen ndryshimet. Ja po sjellim një shembull nga një shpjegim i një opionistit nga Tirana: "Dikur moti mbreti Ahmet Zogolli e kishte futur në psikiatrinë e Vlorës kryeministrin e parë shqiptar, Sulejman Delvinën. Dhe kur njerëzit i thoshin pse s'dilte nga spitali, ai përgjigjej: E ku të shkoj? E gjithë Shqipëria një spital psikiatrik është". A mos vallë disa ditë më parë, ca deputetë të nderuar mëtuan që Kuvendin Popullor ta shndërrojnë në psikiatri!?, a mos vallë atypari u duk Nero ni i tërbuar!..., a mos vallë të gjithë ishin vërtetë të marrë apo shtireshin si budallenj! Unë nuk e di andaj, nuk dua të paragjykojem.

Por, para se ta ndërtoja paragrafin që llafova një vaki, m'u desh fillimisht ta kërkoja e ta takoja plakun mendjendritur të mëhallës sime, këtejpari në Tetovë, për ca "nasijate" (këshilla) rreth ndodhive të fundit në kuvendin e Shqipërisë londineze, ku përfaqësuesit e popullit u grindën mes vete. Ka shumë kohë që plakut i ka ikur nëna e "çunave" të tij nga kjo "dynja". E takova në një vend ku bashkëmoshatarët e tij nuk duken më atypari. Zakonisht "kurdiset" afër banakun të mejhanes së tij të preferuar. "Çehrja" e tij e zbehtë sikur shpjegonte se ishte duke e boshatis gotën e fundit. "Hë. Mirë që më takove", tha plaku (asnjëherë nuk të thotë, mirë që të takova!). Më urdhëroi duke më thënë: "Thirrre mejhanexhiun dhe thuaj të na sjellë edhe dy". I thashë: Do më kursesh mua me gotën e dytë, doktori ma ka ndaluar! "Ehe, ore qerrata, lëre atë heqimin tënd anadolak, ta ka ndaluar ty, që t'i shtohet edhe një atij". Nuk i bëra inat, sepse plaku e ka këtë haber për doktorin. E ç'kemi, i parashtrova pyetjen. Ma ktheu: "Nuk më bëjnë punët (pavarësisht se jeton si Ali Pashai i Tepelenës, të bën budalla para sysh). Këta "çunat" e mi që janë bërë prindër, nuk m'i marrin për tamam këshillat, as në sabah as në aksham, po as pordhat nuk m'i dëgjojnë më (eh ç'më zuri belaja me plakun, unë kisha dertin karshi idesë për shkrimin e radhës, e ky "dertin" e tij), sa herë u përcjell urime me ndonjë sebeb, aq herë nuk m'i kthejnë selamet". Plakut iu trazua fiquiri dhe ulëriti duke thënë: "Vallë a kam unë kërthizë, koqe dhe prapanicë..." dhe ua shau mamanë "çuna-

ve" të tij, "rahmet" pastë! "Po nga dolën këta"... ia ktheva, sigurisht nga dajallarët (jo bash saktë nga dajallarët, e sajova, me "demek" për ta qetësuar sado pak). "Po kjo shumë e saktë, miku! Dajallarët e tyre dikur kishin hije të çunave të Stambollit!" (Eh, plak "namqor", zonjën e kishte nga një familje namusqare, e "plasi" plakën ky vetë). "Ti mik, qofsh nga jugu, veriu, perëndimi a lindja, qofsh gegë, toskë, mysliman, shehërli me NËNË katundi, a bektashi, qofsh në rrugën time a në rrugën tënde të gabuar (ku gabova tashti në këtë moshë), më dëgjo me vëmendje ç'do të them - nëse ke pak koqe, mos mi merr për ters llaftë që t'i them, nëse do dëgjosh pordhat e plakut do degdisësh në haremin e grave të padishahut nëse ke fat, nëse nuk do kesh fatin, atëherë mund të të çojnë në haremin e dylberëve të Sulltanit, atje ku jetojnë, kopilët e kurvit! Bëj kujdes se kopilët e kurvit të mësojnë së prapthi... dhe të mësuarit së prapthi të sjell telashe, të bën me nam të keq dhe, së fundi, do të të përgojojnë rrugëve e skutave të shehrit, njësoj siç unë e përgojoj atë hajdutin e regjur të lagjes sime, të cilin nuk e doja as për dynja e as për ahiret, sepse në kohë lufte bëri haj-

dutërinë me ndihmat dedikuar refugjatëve të luftës së Kosovës! Jazëk qoftë! Andaj mos i hedh nasijatet e mia!" (eh ç'nasijate se!). Duke më përfunduar durimi, vendosa të ik me "hyxhym", ja hoqa një të sharë të ulët orientale allaturka dhe një, oksidentale allafërnga - toptan mbarë e prapë. Për këto fyerjet e fundit nuk hidhërohet, sepse i ka për merak!

I dashur mik, do më ndjesh sepse për pak do ta anashkaloja paragrafin e sipërpërmendur dedikuar vakisë në Tiranë. U dalldisa me plakun mendjendritur a mendjefemër. Nëse disa gjëra mund të lihen mënjanë a në harresë me pahir..., disi mund të arsyetohen..., por ama kur ato lihen padrejtësisht dhe me qëllime dashakeqe, jashtë kujtesës sonë kolektive, atëherë kjo është e pandershme, e pafalshme dhe e paarsyeshme, njësoj siç është e pajustificueshme vakia në Kuvendin Popullor të Shqipërisë londineze, sidomos sjellja e pahijshme e një deputeteje të respektuar, e një nëne të dashur, e një motre serioze, e një femre që duhet të reflektojë kulturë politike, e një gruaje të parë të shtetit shqiptar. Sikur të ishte një gocë e re, ndoshta disi do të kërko-

Para se ta ndërtoja paragrafin që llafova një vaki, m'u desh fillimisht ta kërkoja e ta takoja plakun mendjendritur të mëhallës sime, këtejpari në Tetovë, për ca "nasijate" (këshilla) rreth ndodhive të fundit në kuvendin e Shqipërisë londineze, ku përfaqësuesit e popullit u grindën mes vete



nim ndonjë arsyetim, qoftë edhe të zbehtë, sa i përket sjelljes së ethshme dhe të shfrenuar të saj! E gjithë kjo sjellje e saj, nuk i nderon nënat, motrat a edhe gocat shqiptare, po as mësueset a zyshat që merren me edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja. Monikë e dashur! Pa na thuaj, ç'të duhej të hallakatesh, po moj zonjë, a e di se femrës a nënës së bukur shqiptare nuk i shkon rebelizmi, nuk i shkon inati homerik, nuk i shkon vrazhdësia, qoftë ajo edhe politike. Ne duam që të jesh e veçantë, sidomos ne që jetojmë përtej kufijve administrativë të shtetit amë, sidomos ne që kemi një kujtesë më të moshuar pamore dhe dëgjimore, ne këtej gardhit që asnjëherë nuk deshëm ta "kujtojmë a edhe ta kuptojmë" atë poezinë e Pashko Vasës: "O moj Shqipni, e mjera Shqipni, kush të ka qitë me krye në hi? Ti ke pas kenë një zonjë e randë, burrat e dheut të thirshin nanë...", Jo vetëm sjellja e Monikës motër, duhet kujtuar edhe sjelljen e burrave politikanë gjithandej trojeve të Shqipërisë të Nolit, të Faikut, të vëllezërve nga Frashri, të Migjenit, Fishtës dhe të tjerëve poetë që i kënduan mëmëdheut shekuj me radhë. Monikë e nderuar dhe ju të

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delgev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 21 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: LIRIM DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tjerë politikanë, mos harroni se edhe ne këtej gardhit kemi hise shpirtërore në Shqipëri, edhe për ne shqiptarët këtejpari, sllavët, ndërtuan burgje fashiste, pse e donim vendin që sot ju doni ta "qitni me krye në hi!?" Eh, sa shumë paskësh të drejtë Pashkoja në poezinë e tij! Ne që dikur nuk donim t'i "këndonim dhe t'i kuptonim" vargjet e tij, sepse, thjeshtë, nuk donim të "besonim". Ju të nderuar politikanë të Tiranës, nëse na konsideroni si hisedarë nga etërit tanë, ju lutemi mos na e fikni hisenë tonë.

Poeti Andon Zako Çajupi dikur moti kishte shkruar: "Po ta zuri rrota bishtin, lëre ta këpusë, se pa bisht njeriu jeton, por pa rrotë nuk ka ku shkon". Këtë thënie të mençur të Andonit, unë sot e gjithë ditën e Perëndisë nuk e "kuptova". E di se dikur në Beogradin e Esad Mekulit serbët ua kishin ngjitur bishtin sharrëxhinjve shqiptarë. Unë që jetoj këtej nga anëtona, nuk kam habere se a e "kam bishtin dhe rrotën". Ndoshta me sebpin e radhës PLAKU MENDJE-NDRITUR do të ma japë "hazërxevapin". Tekefundit, "nuk është kurrë as herët as vonë për shqiptarin që s'bën asnjë punë". Unë këtë nuk e prodhova vetë, vetëm e citova Nolin nga Ibrik-Tepeja. Unë bëra shkrimin dhe kurrëgjë tjetër. Besoj se nuk përgojvoja njeri.

As pagës nuk i gëzohemi

Nga Bajram SELMANI



Dikur e prisnim pagën muojore me gëzim, ndërsa sot më tepër ndjemë ankth, ngase edhe kur presim, edhe kur e marrim nuk i plotësojmë "boshllëqet" shpirtërore e jo më ato të ekzistencës. Paga është bërë maktësi i madh se vihesh para dilemave, çfarë obligimesh të përmbushësh e çfarë të mbesin të papërmbushura. Sapo të kaloi rroga softuerin për disa çastesh furia e obligimeve dhe pritjeve të zënë frymën. Shpresa përnjëherë të humbet, e askund nuk e sheh! Pritja deri te rroga është e gjatë, jo muaj po vite. Vonesat i shtojnë vitet, e rrisin ankthin (zhdukun shpresën në organizata që mbrojnë të drejtën e punës e pagës!), në shumë kuptime: bie fjala, deri te paga janë shpenzuar edhe disa paga të tjera, janë huazuar edhe borxhet të tjera, janë rritur edhe çmimet ushqimore me pakicë, pagesat e komunaleve presin te derra, hiç më pak edhe kërcënimi nga norma e interesit që është e lart ndaj shpenzimit të parakohshëm të pagave, obligimi për t'i kthyer huat gërshetohet edhe me ndërjegje morale e pabesitë fjalës, rritja e çmimeve drejtpërdrejtë ndikon në uljen e vlerës së pagës, pagesat komunale të radhës, vetëm sa grumbullohen e me këtë edhe kërcënimet e shkyçjes prej tyre e padisë para përmbuesve, për sa kohë je nën presionin e përmbushjes së këtyre nevojave dhe obligimeve për aq më tepër je nën presionin moral, "se mos un" ndoshta nuk qeverisë mirë me të ardhurat, se ndoshta

mospërmbushja e obligimeve do të ndikojë në uljen e besimit të mjedisi njerëzor, se mos prestigji shoqëror bëhet një kategori inekzistuese.

Angazhimi në marrëdhënie pune duhet të përmbush aspektin e njerëzores si "qenie e punës", në përputhje me këtë edhe shpërblimi si rezultat i angazhimit. Ndarja shoqërore e punës ndikon

në përzgjedhje të profesionit. Disa profesione janë më fitimprurëse, si bie fjala ato të mjekësisë, avokaturës e përmbuesve, e disa më pak, mandej fare pak punëtorët e krahut. Për profesionet më fitimprurëse përzgjedhja e ngritjes profesionale është më rigorozë e në disa raste më korruptuese! Për regjistrimin e mjekësisë e ngritjen profesionale në të, duhet mbështetur o në aftësinë mbi mesatare të inteligjencës ose në mbështetjen e fortë të organizatës/tave si çështje korrupsioni. Jo më ndryshe është edhe në shkencat juridike. Pak kush prej tyre mund të bëhet i përzgjedhuri i profesionit të ëndërruar. Lufta për pushtet ndër ne është e pakompromis. Në këtë aspekt, në disa raste jemi në nivelin e mendimit mesjetar për të. Pushteti është absolut, ai është i pandashëm, te ne vetëm si tillë kuptohet! Kurrë në kuptohet si menaxhues i të ardhurave publike, i nevojave zhvil-

Nuk thuhet kot "një mandat pak e dy tepër".

Ngase premtimet e deklaruara kur nuk përmbushen



luese të ekonomisë në pajtim me ekonominë e tregut, organizuese i shpërndarës i të mirave materiale: përmbi të gjitha faktor sigurie e perspektive i qytetarëve, në pajtim me legjislacionin dhe interesat e tyre. Zhgënjimi sa vjen e rritet, për faktin e thjeshtë se qytetarët që e kalojnë "pragun" e mirëbesimit te qeveritarët, "bëhen me done, edhe pse ishin pa done"! Vetë qeveritarët vijnë në pushtet me deklarinim e vazhdueshëm për një qeverisje të mirë, në periudhë të caktuar kohore. Por, pushteti korrupton, në kuptimin sa më gjatë në pushtet aq më shumë shanset për korruptim rriten. Nuk thuhet kot "një mandat pak e dy tepër". Ngase premtimet e deklaruara kur nuk përmbushen. Për kundër kësaj qytetarët presin jo vetëm përmbushjen e premtimeve por edhe avancimin e tyre. Pra, jo vetëm premtim për integritet në Unionin Evropian, në kuptimin e përputhjes së legjislacionit vendor me të Unionit, por edhe barazi të mirëqenies sociale e rritje standardi jetësor. Përndryshe çfarë kuptim do të kishte fjala "ne dëshirojmë atë integritet evropian". Përdryshe thuhet integritet në strukturat "euroatlantike" nuk mjafton vetëm fjala e thënë, por qytetarët kërkojnë rritjen e sigurisë konform premtimit e angazhimit për të.

Dëshmia jonë tregon se ne për qasje plotësim nevojash ekzistence, e "tepricës" në profesione të ndryshme, rrjedhimisht papunësi, kërkojmë me ngulm hapjen e tregut evropian për ne. Disa mandej "hapjen e kësaj porte" e kanë arritur në mënyra të ndryshme, duke ndërruar identitetin e shtetit, kombit e profesionit, herë duke u thirrur në moshë e herë duke u thirrur në mungesë perspektive ekonomike si kuadër, që të tjerëve edhe ndoshta ju mungon. Një mundësi hapje të kësaj "porte" çdokush do ta kërkonte për sa kohë ndihet i depersonalizuar, i zhgënjyer, skamnor edhe "atëherë kur duhet të ketë" e i pa perspektive për çështjen e familjes. Ta ndjesh një prind që me ditë i thyen duart, për mungesë të një ero në ditë konsumi për kokë anëtarit të familjes, një kryefamiljar që nuk mund të gjejë asnjë fjalë ngushëllimi se e nesërmja do të jetë më e mirë, një të ri që për ditë me radhë brend rrugëve herë duke u lutur e herë duke u bërë servil i njerëzve të pushtetit, vështirë se mund të arsyetohet sot me dashurin për emrin, atdheun, për kombin, gjuhën e për flamur. Sot çdokush është i vetëdijshëm për boshllëkun e fjalëve. Askush nuk han nocione abstrakte, por kërkon përmbushjen e nevojave të ekzistencës me sende konkrete. Unifikimi i mendimit për këtë, më nuk përjashton shtresat e ndryshme shoqërore. Bile as elitat shoqërore e politike.

Përçarje serioze në BE për shkak të refugjatëve

Nga Bernd RIEGERT



Kuotat e detyrueshme për marrjen e një numri të azilkërkuesve, për të cilat ka pasur grindje në samitin e BE, janë harruar. Marrëveshja për kuota nga shtatori i vitit 2015, si një masë për shpërndarjen e ngarkesës me refugjatët, ka qenë e afatizuar për dy vite. Por koha ka kaluar dhe kuotat nuk janë respektuar. Ndërkohë që vazhdimi i këtij afati nuk është parashikuar. Gjykatat Evropiane i ka hedhur poshtë ankesat e Hungarisë dhe Sllovakisë, kundër kuotave. Edhe ato kanë qenë të detyruara të marrin azilkërkues nga Greqia dhe Italia. Kërkesa e vetme e Komisionit të BE tani është që disa mijëra refugjatë që janë identifikuar për shpërndarje, të shpërndahen. Fjala nuk

është më për 120.000 por më së shumti për 9.000 persona. Por vendet e Vishegradit: Polonia, Hungaria, Sllovakia dhe Çekia refuzojnë të pranojnë azilkërkues. Edhe Franca, Austria dhe Spanja si dhe disa vende të tjera kanë pranuar shumë më pak në dy vitet e kaluara, sesa ishte e parashikuar.

Presidenti i Këshillit të BE Donald Tusk ka plotësisht të drejtë kur thotë se sistemi nuk ka funksionuar dhe se vendet e BE janë të përçara. Këtë ka pranuar edhe i ngarkuari i BE për Migracionin, Dimitris Avramopoulos, në shtator të këtij viti. Shifrat dhe faktet flasin kundër kuotave. Pse Avramopoulos e sulmon Tuskun si "antievropian" mbetet sekrete. Këtu bëhet fjalë për një grindje të hidhur mes qeverive po-

puliste prej Varshavës e deri në Vjenë në njërin anë, si dhe qeverive të Gjermanisë, Italisë, Greqisë dhe Komisionit Evropian në anën tjetër. Këtu nuk bëhet fjalë për kuota por për respektimin e parimeve. Sa solidaritet ka në mesin e vendeve të BE? Çfarë vlerash respektohen? BE nuk mund të lejojë që vendet anëtare si Polonia, Hungaria dhe të tjerat të veprojnë më kështu. Por nga ana tjetër nuk lejohet as që ato të futen nën trysni tepër të madhe, sepse reagimi mund të jetë mbrojtja dhe kundërshtimi, nxitja e elementeve nacionaliste dhe pohimet se këto vende trajtohen si shtete të klasit të dytë në BE. BE nuk mund të lejojë që vende anëtare, që bartin barrën më të madhe të azilkërkuesve, të mbeten të vet-

muara. Greqia dhe Italia duhet të ndihmohen. Por kuotat e dhunshme duket se nuk janë metoda më e pranueshme. Në BE funksionon si duket vetëm "solidariteti i jashtëm", pra mbrojtja e kufijve të jashtëm, pavarësisht se cilat janë pasojat për azilkërkuesit dhe migrantët nga Libia për shembull. Ndërsa njerëzit që mbërrijnë në Evropë duhet të shpërndahen në mënyrë solidare, gjë që nuk po funksionon. Këtu nuk po funksionon sistemi i vlerave.

Apelet morale kundër ksenofobisë së kryeministrit hungarez dhe miqve të tij në klubin e Vishegradit, nuk do të ndihmojnë. Por vendet anëtare që e financojnë BE-në duhet të kërkojnë solidaritet të brendshëm. Vendeve që pranojnë para, si Polonia, Hungaria, Çekia

dhe Sllovakia, duhet t'u shkurtohen ndihmat, sepse këto para duhet t'u jepjen Greqisë dhe Italisë, për të sistemuar refugjatët. Kancelarja Merkel ka kërcënuar me një mundësi të këtille para një viti - por kjo nuk ka ndihmuar deri tani aspak. Vitin e ardhshëm mund të zgjidhet problemi, sepse BE gjatë këtij viti do të fillojë negociatat për buxhetin e ri deri në vitin 2020. Ai që nuk i përmbush detyrimet, duhet ta vërejë këtë tek ndarja e parave. Ky nuk është ndonjë mjet elegant, por ndoshta i vetmi për të detyruar vendet jo solidare që t'i përmbushin obligimet. Përçarjet politike në BE me siguri që nuk do të zgjidhen në këtë mënyrë. BE gjendet para një sprove shumë të rëndë. (dv)

**SANIJE SADIKU,
ISH KRYETARE E OSLLOMESË**

E KEQJA NUK MUND

TË MBISUNDOJË

TË MIRËN

Stereotipet kundrejt femrës dhe pozitës së saj në poste publike, janë një realitet i hidhur që përcillet nga frika e dështimit, frika e paragjytimeve, të cilat janë mekanizmat kryesorë që e ndalojnë kreativitetin e tyre. Gruas shqiptare duhet t'i ofrohet rasti që të marr pjesë në proceset politike në vend, sepse atributet e tyre janë të pamohueshme. Ishin ato nëna që rrinin të uritura për të na ofruar kafshatën e fundit, janë ato nëna që rritën heronjtë dhe mendjet e ndritura të këtij vendi dhe është përkushtimi i po atyre nënave që qëndrojnë të palëkundura përpara çdo stuhie

Delvina KËRLUKU

Sanije Sadiku, e lindur në fshatin Sërbicë të Kërçovës. Rrjedh nga një familje arsimdashëse me tradita kombëtare, ku shkollimi i femrës nuk paraqiste problem. Pesë motra dhe një vëlla, të gjithë u shkolluan. Shkollën fillore e filloi në "Sken-derbeu" në fshatin Sërbicë, kurse e kreu në SH.F. "Sande Shterjoski" dhe gjimnazin në "Mirko Mileski", në Kërçovë. Në vitin 1983/84 regjistrohet në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Kosovës. Diplomoi në mars të vitit 1988, me sukses të shkëlqyeshëm dhe mori titullin inxhinier i diplomuar i agronomisë. Pas mbarimit të fakultetit, për shkak të rrethanave të asaj kohe, nuk u krijuan kushte për punësim dhe pas një pauze të gjatë, për herë të parë punësohet në korrik të vitit 1997, në Komunën e Oslomesë, si referente për çështje të përgjithshme. Në maj të vitit 2000 emërohet udhëheqëse në Njësinë rajonale për kullosa në Kërçovë, q përfshinte edhe qendrat e Makedonski Brod, Demir Hisar dhe Krushevë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000 emërohet kryetare komune në Oslome, si femra e parë shqiptare, të cilin mandat e fitoi edhe në zgjedhjet lokale 2005 – 2009, ku përsëri ishte e vetmja shqiptare.

KOHA: Keni qenë kryetare e Oslomesë, komunë kjo që shtrihet në verilindje të Kërçovës. E vetmja femër shqiptare deri atëherë, si kryetare e një komune në Maqedo-

ni. Si arritët të ngjiteni në këtë komunë dhe cili është kontributi juaj në mandatin katër vjeçar?

SADIKU: Stereotipet kundrejt femrës dhe pozitës së saj në poste publike, janë një realitet i hidhur që përcillet nga frika e dështimit, frika e paragjytimeve, të cilat janë mekanizmat kryesorë që e ndalojnë kreativitetin e tyre. Gruas shqiptare duhet t'i ofrohet rasti që të marr pjesë në proceset politike në vend, sepse atributet e tyre janë të pamohueshme. Ishin ato nëna që rrinin të uritura për të na ofruar kafshatën e fundit, janë ato nëna që rritën heronjtë dhe mendjet e ndritura të këtij vendi dhe është përkushtimi i po atyre nënave që qëndrojnë të palëkundura përpara çdo stuhie. Unë isha vetëm një lajmëtare e kohës, për herë të parë garonim për pushtetin lokal gjinia femërore si nga pala shqiptare, po edhe maqedonase. Të pakta ishin edhe gjatë fushatës zgjedhore. Nga 123 komuna që ekzistonin atëherë, vetëm në tri komuna iu dha besimi të udhëhiqeshin nga kryetare gra, edhe atë komuna Qendër në Shkup, Miravci në Gjevgjeli dhe unë në Komunën e Oslomesë. Më duhet të theksoj se atëbotë nuk pati asnjë femër në Këshillin e komunës. Gjatë ushtrimit të funksionit të kryetarit në të dy mandatet, u përkushtova në realizimin e projekteve që kishin të bëjnë me sigurimin e ujit për pije, si një nga problemet kyç të popullatës, pasi nga puna e termocentralit të Oslomesë, shterën pusët nga ku furnizoheshin me ujë banorët e kësaj ane.

Fal ndihmës së institucioneve të vendit, ambasadave të huaja, si ajo e Norvegjisë, Zvicrës, pastaj USAID, UNDP, SIP etj., arrita së paku të zgjidh problemin e ujit si dhe disa projekte të kanalizimit, infrastrukturës rrugore, ndërtimin dhe rekonstruimin e shkollave, urave, aktivitetet kulturore dhe sportive. Paralelisht me kryerjen e detyrave si kryetare komune, jam marrë edhe me aktivitete tjera me interes shoqëror dhe kombëtar.

Nga viti 2009 vazhdova të punoj si këshilltare për veprimtari publike në Komunën e Oslomesë.

Me bashkimin e komunave punoj si udhëheqëse e njësisë për arsim, sport, mbrojtje sociale dhe shëndetësi në Komunën e Kërçovës.

KOHA: Ju zgjidheni për së dyti si kryetare e Komunës së Oslomesë. Kjo do të thotë se çdo grua, që kup-

ton problemet e drejtimit të një shtëpie, do ta ketë më të lehtë të kuptojë problemet e drejtimit të një komune?

SADIKU: Sfera e qeverisjes lokale është më e afërt me qytetarët. Po edhe mandatin e dytë ishim vetëm tri gra kryetare komune në nivel të Maqedonisë, në Komunën Qendër, Krushevë dhe unë në Oslome. Por, tani në këshillin e komunës ishin 5 këshilltare femra. Kryesisht projekte që kanë të bëjnë me kompetencat e ligjit për pushtet lokal infrastrukturën, planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e ambientit, veprimtaritë publike si arsimit, kultura, sporti, mbrojtja sociale dhe e fëmijëve etj.

Si kryetare komunë të vetmin privilegj kam pasur takimin me politikanë të mëdhenj botërorë, që mund të konsiderohen me të drejt dhe meritë njerëz të famshëm, si për shembull, me sekretarin Shtetëror

amerikan, Kolin Pauell, ambasadorë, institucione të ndryshme gjatë udhëtimeve zyrtare si në: ShBA, Shqipëri, Hungari, Gjermani, Suedi, Itali, Bullgari, nga të cilat fiton përvojë institucionale.

Në Piza të Italisë ka marrë pjesë në miratimin e Kartës evropiane për barazinë e femrave dhe meshkujve në jetën lokale, e përgatitur nga Këshilli i komunave dhe rajoneve evropiane. Kjo kartë ju drejtohet të gjitha qeverive lokale dhe rajonale të Evropës, të cilat janë të ftuara ta nënshkruajnë, të bëjnë përbetimin formal publik për parimet e barazisë të femrave dhe meshkujve dhe ta implementojnë brenda territorit të tyre.

Angazhimi dhe lobimi i fuqishëm brenda katër viteve me dy kryetaret tjera femra, lobin e grave në RM, sektorin për barazi gjinore pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale arritëm të fitojmë



kuotën prej 30 për qind që në listat zgjedhore për këshilltarë të jenë femra. Ashtu që në mandatin e dytë 2005-2009 nga 15 anëtarë të këshillit, 5 ishin femra që do të thotë 30 për qind.

KOHA: Keni qenë pjesë edhe më herët e kësaj Komune. Duke i njohur problemet e komunës tuaj, arritët të merrni në dorë që t'i përmirësoni. Në fakt, çfarë problem e kanë preokupuar këtë komunë në të kaluarën dhe sot?

SADIKU: Kryesisht probleme të infrastrukturës që kishin të bëjnë me sigurimin e ujit për pije, kanalizimit, infrastrukturës rrugore, ndërtimin dhe rekonstruimin e shkollave, urave, aktivitetet kulturore dhe sportive, zhvillimi i qëndrueshëm, planifikimi urban dhe lokal, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit jetësor etj.

KOHA: Jeni inxhinier e agronomisë. Përse zgjodhët këtë profesion, aq më shumë për një femër?

SADIKU: Bëhet fjalë për vitet 1983 – 1984. Atëherë, po edhe sot, profesioni agronome ishte deficitar, shpresa për të ardhur më shpejt te punësimi, por për shkak të rrethanave të asaj kohe, të diplomuarit në Kosovë etiketoheshin si të papërshtatshëm për vendin. Pas një pauze dhjetëvjeçare punësohem, por fatkeqësisht kurrë nuk e ushtrova profesionin e agronomes.

KOHA: Politika bujqësore synon të rris produktivitetin e bujqësisë, të sigurojë një nivel jetese të drejtë të popullsisë që merret me bujqësi, të stabilizojë tregjet, të garantojë sigurinë e furnizimeve, të sigurojë çmime të arsyeshme për konsumatorët. Këtyre u shtohen dhe parimet e respektimit të mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, që të rrisë besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Si i shihni politikën bujqësore, në Maqedoni?

SADIKU: Politikat bujqësore përcaktojnë objektivat, masat dhe programimin e zhvillimit bujqësor dhe rural, të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionin për politikën në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

KOHA: Maqedonia, aktualisht importon një numër të konsideruar të prodhimeve, duke filluar nga lënda e parë, prodhimeve bujqësore të gatshme, por edhe ushqime. Për të



aplikuar të arriturat dhe risitë nga lëmi i Ekonomisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, shteti duhet të kontribuojë në shtimin e rendimenteve për njësi të prodhimit dhe sigurim të mjaftueshëm të ushqimit për vendin, po edhe me gjerë. Si e shihni rritjen e rendimenteve të prodhimit në RM?

SADIKU: Në Bashkimin Evropian, politika bujqësore e përbashkët (PAC) është një prej politikave më të vjetra dhe më të rëndësishme të politikave të përbashkëta të BE (rreth 35 % e buxhetit evropian, nga e cila 45% përdoret për zhvillimin rural). Ajo synon të rrisë produktivitetin e bujqësisë, të sigurojë një nivel jetese të drejtë të popullsisë që merret me bujqësi, të stabilizojë tregjet, të garantojë sigurinë e furnizimeve, të sigurojë çmime të arsyeshme për konsumatorët. Këtyre u shtohen dhe parimet e respektimit të mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm,

që të rris besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

KOHA: Çfarë do të thotë për Ju, politikë, është aq e vështirë ajo në Maqedoni, aq më shumë për një femër?

SADIKU: Gjatë vijimit të studimeve në Prishtinë, të gjithë studentët nga Maqedonia, Presheva Malësia e Tuzit interesoheshin për fatin e kombit, që ishte një represion i dyfishtë ideologjik dhe institucional, duke u munduar të ndryshojnë realitetin që sundonte. Këto synime permanente, njeriun e shtyjnë që të bëjë diçka sadopak të dobishme për popullin, respektivisht e shtyjnë që të ndjekë rrugën e vështirë të politikës. Pra, një përfaqësim i barabartë i grave në politikë, është parakusht për funksionimin e demokracisë, për ndryshime sociale dhe zhvillim ekonomik. Gratë kanë interesa, nevoja dhe eksperiencia të ndryshme nga

burrat dhe këto interesa mund të përfaqësohen vetëm nga gratë e jo nga burrat dhe për këtë arsye duhet të ketë përfaqësim të barabartë të dy gjinive.

KOHA: Një politikan mendon për zgjedhje të ardhshme, kurse një udhëheqës shteti apo komune mendon për brezin e ardhshëm. Si mendoni?

SADIKU: Koha i ka dëshmuar të gjitha se dominimet e çfarëdo lloji qofshin janë "boomerang" i rrezikshëm etnopolitik, janë përjetuar eksode etnike dhe politike, por realiteti faktik ka mbetur i njëjtë. Është e ditur se e keqja nuk mund të mbi-sundojë të mirën, është një ligj hyjnorë dhe shoqërorë që nuk mund të ndryshojë. Qytetarët presin mirëqenie, begati dhe përparim në sferën institucionale, ekonomike, sociale, juridike, të shkrihen dallimet e imponuara, favorët e pamerituara.

KOHA: Si udhëheqëse e sektorit të arsimit, në komunën tuaj, çfarë mund të na thoni për ecurinë e arsimit në Maqedoni, veçmas në Komunën e Kërçovës?

SADIKU: Arsimi fillor dhe ai i mesëm në Republikën e Maqedonisë është i garantuar me ligj dhe i obliguar. Në Komunën e Kërçovës kemi nëntë shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme.

Brenda spektrit të kompetencave mundohemi të sigurojmë dhe promovojmë qasje të barabartë për edukimin dhe trajnimin profesional dhe të vazhdueshëm për të gjithë. Me keqardhje mund të konstatoj se numri i nxënësve në vitet e fundit është në rënie.

Qëllimi për t'u ngritur rejtingu i Maqedonisë në nivel të matjeve ndërkombëtare të shkallës së arsimit mund të arrihet së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byrosë për zhvillim të arsimit me mesimdhënësit, me prindërit, me nxënësit dhe me mbështetjet e organizatave joqeveritare. Reformat janë të domosdoshme.

KOHA: Të jesh nënë, do të thotë të jesh drita e shtëpisë. Grua, krahu i djathtë i burrit. Kryetare e komunës, kujdestare e banorëve. Cila është vlera më e madhe që keni?

SADIKU: Një femër sot është një vajzë, një grua, bashkëshorte, mjeke, gazetare, politikane, misionare, mësuese, e me radhë dhe për të ofruar më të mirën e saj në familje dhe shoqëri, ajo duhet të jetë prezent, aktive në rolin e saj dhe me përkushtim, dashuri dhe përgjegjësi të ofroj modelin dhe kontributin e saj. Jam bashkëshorte, nënë e tre fëmijëve: Gëzimit, Arbënorës dhe Arbërinës. Më duhet të theksoj se mbështetja e bashkëshortit, familjes më të ngushtë, kolegëve dhe rrethit ku jetoj dhe veproj nuk më kanë munguar. Më lejoni t'ju shpreh të gjithëve falënderim publik. Ne duhet të ofrojmë modelin tonë pa u lodhur çdo ditë, sepse kemi të gjithë nevojë për një jetë më të mirë, për dialog dhe bashkëpunim. Pa këto ne nuk do mund të jemi dot të realizuara si pjesëtare të shoqërisë që i përkasim. E rëndësishme është se çfarë do bëjnë gratë me veten e tyre, për të pasur të garantuara në mënyrë integrale të drejtat e qytetarisë femërore në familje dhe shoqëri, si vlera dhe cilësi universale për të qenë qytetare të barabarta dhe të vlerësuara si të tilla në familjen dhe shoqërinë shqiptare...



VAGABOND: Shqipëria, vendi më i mirë i vitit 2018

Vagabond është revista më e madhe e Suedisë për udhëtime dhe ka listuar 35 destinacione në gjashtë kategori: vendet më të mira, qytetet më të mira, aventurën më të mirë, më të mirët e diellit dhe banjot, udhëtimet më të mira ushqimore dhe udhëtimin më të mirë buxhetor, ku Shqipëria renditet e para. Lajmi është postuar në faqen e ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku thuhet: "Shqipëria po promovohet nga mediat ndërkombëtare si një nga destinacionet më të mira turistike për vitin e ardhshëm 2018. Vendi është në krye të 35 destinacioneve për t'u vizituar në 2018, sipas Vagabond Beresta Editorial". Siç transmeton ATSH, në artikullin kushtuar Shqipërisë thuhet se "Fituesi në kategorinë më të mirë është Shqipëria - një vend që së fundi ka qenë një ushqim i mirë në botën e udhëtimit, pasi ajo ka gjithçka, nga majat e thyera malore deri te plazhet e artë mesdhetare". "Shqipëria lë dy vende: Botswana dhe Zvicra. Të dhënat zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT) konfirmuan se numri i turistëve nga tregu evropian në 2016 vizitorët nga Suedia u rritën me 63 për qind", citon Vagabond. "Këtë vit, bordi redaktues ka listuar 35 destinacione në gjashtë kategori: vendet më të mira, qytetet më të mira, aventurën më të mirë, më të mirët e diellit dhe banjot, udhëtimet më të mira ushqimore dhe udhëtimin më të mirë buxhetor. Fituesi në kategorinë më të mirë është Shqipëria, pasi ajo ka gjithçka, nga majat e thyera malore deri te plazhet e arta mesdhetare".

KORRUPSIONI NUK PO LUFTOHET



"Ne kemi nevojë që të kemi Kosovën partner dhe si miq kemi të drejt të pyesim ku janë rezultatet. Rezultatet mungojnë nuk ka asnjë person të profilit të lartë të dënuar me dënim të lartë për shkak të korrupsionit. Këtë vit prej tre rasteve dy kanë dështuar ku po mbetet llogaridhënia", tha Ruairi O'Connell, ambasadori i Britanisë së Madhe

Ruairi O'Connell, ambasadori i Britanisë së Madhe, tha se Kosova nuk ka sfidë më të madhe sesa luftimi i korrupsionit, e sidomos korrupsioni i nivelit të lartë fenomen ky që e shkatërron demokracinë dhe pengon zhvillimin ekonomik. O'Connell më tej shtoi se rezultatet në luftimin e korrupsionit mungojnë dhe se dënimet për personat e profilit të lartë janë simbolike. "Kosova nuk ka sfidë më të madhe sesa luftimin e korrupsionit sidomos korrupsionit të nivelit të lartë ky fenomen e shkatërron demokracinë dhe e pengon zhvillimin ekonomik. Korrupsioni nuk është dukuri vetëm në Kosovë. Kosovarët nuk janë më të korruptuar se sa të

tjerët. Kosovarët janë njerëz të ndershëm dhe të sinqertë, por luftimi i korrupsionit është problem global". "Ne kemi nevojë që të kemi Kosovën partner dhe si miq kemi të drejt të pyesim ku janë rezultatet. Rezultatet mungojnë nuk ka asnjë person të profilit të lartë të dënuar me dënim të lartë për shkak të korrupsionit. Këtë vit prej tre rasteve dy kanë dështuar ku po mbetet llogaridhënia". Sipas tij, Kosova ka nevojë ka nevojë të ketë gjyqtarë dhe prokuror të pastër meritore, raporton Ekonomia Online. Këto deklaratime ai i bëri në tryezën e organizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ku u diskutua për performancën dhe

rezultatet e institucioneve të drejtësisë në luftimin e korrupsionit "Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit? - Zgjidhja/Vetingu?". Gjatë kësaj tryeze u prezantua edhe raporti i monitorimit sistematik të rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, i cili përmban gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si të shtohet efikasiteti dhe efektiviteti i këtyre sistemeve në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Betim Musliu nga ky Institut, tha se profili i rasteve të korrupsionit që ndiqen në Kosovë, është profil i ulët dhe rrallë herë i profilit të lartë. Ai ka përmendur që në vitin 2017,

kanë qenë tre aktakuza të profilit të lartë, e që dy nga to kanë dështuar në faza të hershme të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa është duke u proceduar vetëm në një rast, bëhet fjalë për Shukri Bujën, ish-kryetar i Lipjanit.

Ai tha se ka një rast që trajtohet që nga viti 2004, dhe akoma është në fazën e grumbullimit të informatave ani pse afati për grumbullim të informatave është vetëm 30 ditë. "... personi i dyshuar nga ajo kohë deri tani mbetet në evidencë penale, dhe është shkelje flagrante e të drejtave të personit". Sipas Musliut, ka një rast që ka zgjatur dhjetë vite deri në shpallje të aktgjyqimit.

Demarkacioni, vitin tjetër në Kuvend

Marrëveshja e Demarkacionit me Malin e Zi nuk pritet të dalë në votim para deputetëve gjatë këtij viti, ani pse Qeveria tashmë ia ka nisur Kuvendit këtë marrëveshje. Meqë kanë mbetur edhe 10 ditë

deri në përfundim të vitit 2017, gjatë janë minimale që Demarkacioni të procedohet në Kuvend. Kështu konsiderojnë njohësit e çështjeve politike, të cilët thonë se pa u gjetur një konsensus mes par-

tive (për ta votuar), kjo marrëveshje nuk do të shkojë para deputetëve. Të njëjtën e kanë pohuar edhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit (nga PDK-ja), të cilët kanë thënë se nëse nuk arrihet një marrëve-

shje e tillë atëherë nuk ka nevojë që Demarkacioni të dalë fare në votim. Me këtë rast ata kanë thënë se zhvillime rreth Demarkacionit mund të ketë tek pas Vitit të Ri (2018), shkruan "Zëri".

BASHKËSHORTI I AMBASADORES AMERIKANE NË OKB, ME ORIGJINË SHQIPTARE

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në OKB, Nikki Haley deklaroi se Uashingtoni po përpigjet fort që të gjitha vendet ta njohin Kosovën në Kombet e Bashkuara. Haley i bëri komentet gjatë pritjes së organizuar nga Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Nju Jork dhe Dhoma Amerikane në Kosovë, ku ishin të ftuar ambasadorë të akredituar

në OKB, si dhe përfaqësues të diasporës shqiptare e të bizneseve amerikane. Diplomati e lartë nuk la pa përmendur dhe faktin që bashkëshorti i saj është me origjinë shqiptare, transmeton TCh. "Ne deshëm të merrnim pjesë në këtë aktivitet për disa arsye. Jam këtu me burrin tim, gjyshi i të cilit erdhi në Amerikë nga Shqipëria. Kemi shumë gjëra të përba-

shkëta me kosovarët në komunitetin shqiptar. Ne po përpigemi që Kosova të marrë njohjen e të gjithë vendeve në OKB dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë derisa Kosova ta fitojë njohjen", tha Haley. Arsyeja që e bëjmë këtë, vazhdoi Haley, është se kemi disa vlera të përbashkëta: respektojmë njëri-tjetrin, besojmë tek njëri-tjetri e kemi të njëjtat vlera de-

mokratike. Ajo kujtoi sesi shqiptarët e Kosovës u treguan të gatshëm të ndihmonin kur Teksasi u godit nga uragani këtë vit e shtoi se kjo flet për lidhjet që dy popujt ndajnë mes tyre. Ambasadorja la më tej të kuptohej se prania e saj në event ishte dhe një mesazh i qartë i faktit se Amerika do të vazhdojë të mbetet një vend mik për Kosovën.





Refugjatët jashtë Vjenës

Johann Gudenus, kryetari i grupit parlamentar të Partisë së Lirisë (FPÖ), parti e ekstreme të djathtë në Austri, partner i koalicionit të qeverisë së re, propozoi që refugjatët që jetojnë në Vjenë të vendosen jashtë qytetit për shkak të "veprimtarisë kriminale". Duke folur në televizionin shtetëror austriak ORF, deputeti Gudenus ka mbrojtur idenë e tij se do të ishte më mirë që refugjatët të dërgoheshin në vendbanime jashtë Vjenës deri në përfundimin e aplikimit të tyre për azil. "Një mënyrë e tillë është e mundur për zgjidhjen e problemit. Këto vendbanime mund të ndërtohen në zona me popullsi të ulët dhe azilkerkuesit mund të qëndrojnë këtu deri në përfundimin e aplikimit të tyre", tha Gudenus, duke pretenduar se "refugjatët kryejnë krime". Gudenus, i cili nuk i është përgjigjur pyetjes se ku duhet të vendosen rreth 13,000 njerëz që kanë bërë kërkesën për azil, është shprehur: "Duhet të parandalohet që azilkerkuesit të jetojnë në qytet në grupe të vogla. Mund të kufizohet kjo situatë që shkakton fluks të paligjshëm të refugjatëve. Në këtë mënyrë, emigrantëve u tregohet se Austria nuk është një vend aq i rehatshëm sa mendohet". Kryetari i bashkisë së Vjenës, Michael Haeupl, duke e cilësuar të pakuptimtë propozimin e Gudenus, është shprehur se nuk gjendet një vend ku mund të ndërtohen rreth 150 ndërtesa për refugjatët, ku mund të qëndrojnë 13 mijë persona. Ndërsa zëvendës kryetarja e bashkisë, Maria Vassilakou, tha se "propozimi është poshhtëruar".



TURPI BRITANIK

ME PERSONAT E PASTREHË

Komiteti i Llogaritjeve Publike i Parlamentit Britanik njoftoi se gjendja lidhur me personat e pastrehë është shndërruar në "krizë nacionale". Sipas raportit të komitetit në fjalë, më shumë se nëntë mijë persona jetojnë në rrugë në Britani, kurse 78 mijë familje jetojnë në strehimore të përkohshme, ndërkohë që numri i fëmijëve që jetojnë në këto strehimore arrin në 120 mijë. "Pastrehësia në Britani ka arritur në një krizë nacionale", thuhet në raport, në të cilin theksohet se shtatë vitet e fundit problemi ka shënuar rritje të shpejtë.

Nga viti 2011, numri i personave që jetojnë në rrugë është rritur për 134 për qind, ndërsa i atyre që jetojnë në strehimore është rritur për 63 për qind, thuhet në raport. Komiteti gjithashtu pohoi se në këto statistika nuk përfshihet numri i "të pastrehëve të fshehtë", të cilët janë strehuar te familjarët e tyre pasi kanë humbur shtëpitë ose nuk kanë mundur të paguajnë qiranë. Në raport rikujtohet se qeveria planifikon që deri në vitin 2027 të ulët në zero numri i të pastrehëve që jetojnë në rrugë, ndërsa paralajmërohet se nëse vazh-

dojnë kushtet aktuale, ka gjasa që numri brenda një viti të rritet për 76 për qind. Moshja mesatare e të pastrehëve është 47 dhe probabiliteti për të qenë viktimë të dhunës është 17 herë më i madh se i një qytetari ordiner. Kryetari i komitetit, deputeti nga Partia Laburiste, Mg Hiller, i cilësoi si dështim të turpshëm politikën e qeverisë për problemin e strehimit. Hiller gjithashtu theksoi se qeveria duhet të bëjë më shumë për matjen dhe kuptimin e kostove të vërteta të pastrehësisë dhe vuri në pah rëndësinë e gjenerimit të banesa-

ve të lira. Shoqëria civile paralajmëron se të pastrehët dhe problemi i atyre që jetojnë në rrugë është shumë më i madh sesa që tregojnë regjistrat zyrtarë. Sipas shoqatës St Mungo e cila është e angazhuar me aktivitete për të pastrehët, vetëm në kryeqytetin Londër në rrugë jetojnë nëntë mijë persona. Prej atyre që jetojnë në rrugë, 17 për qind janë nga vendet e Bashkimit Evropian (BE), pesë për qind nga vendet jashtë BE-së, 17 për qind janë femra dhe shtatë për qind janë persona më të rinj se 25 vjeç.

"Më shumë se nëntë mijë persona jetojnë në rrugë në Britani, kurse 78 mijë familje jetojnë në strehimore të përkohshme, ndërkohë që numri i fëmijëve që jetojnë në këto strehimore arrin në 120 mijë"

Sulm me veturë në Melburn, 19 persona janë lënduar

Policia australiane ka arrestuar dy persona pasi njëri prej tyre ka drejtuar një makinë drejt këmbësorëve në qytetin Melburn. Deri më tash është raportuar se të paktën 19 persona janë lënduar. Makina ka goditur "një numër këmbësorësh" në qendër të qytetit, ka thënë policia shtetërore Viktoria. Policia ka thënë se ka arrestuar drejtuesin e makinës dhe një tjetër person që ishte me të. Policia nuk ka qenë



në gjendje të konfirmojë nëse incidenti ishte i lidhur me terrorizëm. Ambulanca shtetërore ka thënë se 13 persona janë dërguar

në spital, disa prej tyre në gjendje serioze. Mediat lokale kanë thënë se 19 persona janë lënduar. Incidenti ka ndodhur në rrufën Flinders, në kohën kur zona ishte e mbushur me persona që po vizitonin tregun e Krish-tlindjeve. Gjatë muajit janar gjashtë persona kanë mbetur të vdekur pasi një furgon u nis drejt këmbësorëve në Melburn. Policia ka thënë se ai rast nuk kishte të bënte me terrorizëm.

ME PLUMBA TË VËRTETË NË PROTESTAT PËR KUDSIN

Usharët izraelitë ndërhyjnë me plumba të vërteta në marshimet e organizuara në Bregun Perëndimor të okupuar në shenjë proteste ndaj vendimit të SHBA-ve për njohje të Kudsit si 'kryeqytet të Izraelit'. Në zona të ndryshme të Bregut Perëndimor, një numër i madh i palestinezëve organizuan marshime në shenjë proteste ndaj vendimit të SHBA-

ve për Kuds. Gjatë këtyre marshimeve, ushtarët e Izraelit kanë ndërhyrë me plumba të vërtetë dhe plastik si dhe me gaz lotsjellës. Gjatë incidenteve, ndaj përdorimit të plumbave të vërtetë dhe gazit lotsjellës nga ana e ushtarëve të Izraelit, të rinjtë palestinez u përgjigjën duke hedhur gurë. Ndërhurje të ngjashme kishin dhe në veriun e Bregut Perëndi-

mor, në qytetin Kalkijla, në postbllokun ushtarak Kalendija që gjendet mes Kudsit dhe Ramallahut dhe në pika të ndryshme të qytetit El-Halil. Gjysmëhëna e Kuqe Palestineze deklaroi se një person është lënduar nga plumbat e gomës në Kalendija. Ndërkohë, pritet që në orët e mërkujës të organizohen protesta të tjera.





info@scboristrajkovski.gov.mk | www.scboristrajkovski.gov.mk

Në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16) dhe nenit 29 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënie me qira të hapësirës afariste e cila është në pronë dhe me të cilën menaxhon Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup (nr. Ark. 02-2148/2 të datës 11.11.2015)

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup
me seli në bul. 8-mi Septemvri nr. 13 Shkup

PUBLIKON
SHPALLJE nr. 02/2017

PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS AFARISTE PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS AFARISTE, në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në pajtim me Pasqyrën tabelore në të cilin janë dhënë të dhëna për hapësirën afariste, nr. i parcelës kadastrale, sipërfaqja të hapësirës afariste, adresa, çmimi i përgjithshëm fillestar, garancia bankare, afati i parashtrimit dhe koha e ankandit publik.

Hapësira afariste e cila është lëndë e ankandit publik elektronik është në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, jepet për periudhë prej 3 (tre) vjet, me mundësi për vazhdim të marrëveshjes.

1. Hapësira afariste e cila gjendet në Vip Pishinën për not në kompleksin Qendra sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të parë).

Nr. r.	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1.	PK 566/4 KK Karposh LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"kafe restorant" në përdhese	182	60.400,00	12.079.947,00	241.599,00	12.01.2018	15.01.2018 10:00
2.	PK 566/4 KK Karposh LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"hapësirë afariste nr. 11" në bodrum	81	18.681,00	3.736.125,00	74.723,00	12.01.2018	15.01.2018 12:00

SHENIM: Ofertuesi më i volitshëm për hapësirën afariste të shënuar si "kafe restorant" në përdhese me sipërfaqe prej 182 m², PK 566/4, KK Karposh dhe LP 47329 që gjendet në Vip Arena në kompleksin e Qendrës sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup me lidhje të marrëveshjes për qira do të jetë i obliguar që dukjen vizuale të vet hapësirës afariste t'i përshatet dukjes së Qendrës Sportive në të kundërtën marrëveshja për qira do të ndërpritet pa afat paralajmëruar.

2. Hapësira afariste i cili gjendet në Vip pishinën në kompleksin e Qendrës Sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të parë).

Nr. r.	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
3.	PK 550/3 KK Karposh LP 4917	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"depo nr. 3" në bodrum	50	8.184,00	1.636.800,00	32.736,00	12.01.2018	15.01.2018 14:00
4.	PK 550/3 KK Karposh LP 4917	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"depo nr. 4" në bodrum	25	4.092,00	818.400,00	16.368,00	12.01.2018	15.01.2018 16:00

3. Hapësira afariste i cili gjendet në Vip pishinën në kompleksin e Qendrës Sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të dytë).

Nr. r.	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
5.	PK 550/3 KK Karposh LP 4917	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"zyra me toaleta hyrja 2" në përdhese	25.50	7.935,00	1.587.069,00	31.741,00	12.01.2018	16.01.2018 10:00
6.	PK 550/3 KK Karposh LP 4917	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	hapësirë afariste në përdhese"	24.80	7.718,00	1.543.502,00	30.870,00	12.01.2018	16.01.2018 14:00

Qiraja përcaktohet me denarë.

Qiraja në marrëveshje për qiranë është dhënë në shumë neto – pa TVSH. Tatimi i vlerës së shtuar shënohet në vend të posaçëm në fakturë. Qiramarrësi obligohet që qiranë ta paguajë në afat prej një dite nga dita e marrjes së fakturës.

Për mos pagesë në kohë të qirasë do të përlogaritet kamatë ndëshkuese ligjore.

Mospagesa e 2 (dy) qirave të njëpasnjëshme mujore, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me qira, paraqet bazë për aktivizimin e mjeteve për siguri dhe bazë për ndërprerje të marrëveshjes nga ana e Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.

TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. **Subjektet fizike:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Subjekte juridike:** person juridik lokal, person juridik në pronësi të përzier, person juridik të themeluar nga personi fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa të cilët me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territor të Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Subjektet e interesuara fizike dhe juridike parashtrorinë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik përmes rrugës elektronike edhe në formë me shkrim, për secilin hapësirë afariste veç e veç, të kompletuar me dëshmitë në vijim:

1. Subjektet e interesuara fizike dhe juridike paraqiten në sistemin për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk dokumentet në formë me shkrim dorëzohen në Shoqërinë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në zarf të mbyllur me shenjë "Mos hap deri në përfundim të shpalljes".

2. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumë prej (2% të vlerës së caktuar) me afat të kohëzgjatjes prej 60 ditëve nga dita e ankandit publik vetëm në origjinal (të shënohet numri rendor nga pasqyra afariste dhe adresa ku gjendet objekti afarist).

3. Për subjektet fizike certifikatë të shtetësisë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj.

4. Për subjektet juridike gjendje aktuale nga Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë (për ofertues të huaj dëshmi përkatëse për regjistrim të subjektit juridik të dhënë nga regjistrin përkatës), në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj.

5. Pjesëmarrësit e interesuar regjistrohen në portalin www.deloven-prostor.mk me futjen e e-mail adresës së parashtruesit të fletëparaqitjes përmes së cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, sipas së cilës do të duhet të aktivizojë llogarinë përdoruese (Shih udhëzimin për shfrytëzuesit të www.deloven-prostor.mk).

6. Deklaratë se në rast se oferta e tij zgjidhet si më e volitshme obligohet të paguajë mjetet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do të shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

7. Gjatë dorëzimit të dokumenteve, ofertuesit të interesuar në fushën "Deklaratë" duhet të fusin një dokument të gjitha dokumentet e nevojshme nga shpallja

përveç Garancisë bankare, ndërsa në sferën "Garancia bankare" dorëzohet garancia e skanuar bankare.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen në së voni në afat prej 23 ditë nga dita e shpalljes, gjegjësisht duke filluar prej 21.12.2017 deri më 12.01.2018 deri në ora 16:00 përmes mënyrës elektronike në internet faqen: www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të mbahet në formë elektronike në internet faqen në vijim www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të fillojë në terminin e dhënë në pasqyrën tabelore, për secilin hapësirë afariste veç e veç.

PROCEDURA

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton kompletimin e dokumenteve në pajtim me kushtet në shpallje, pas së cilës do të informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.

2. Parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në mënyrë elektronike e miraton pjesëmarrjen në ankandin publik pas së cilës informohen përmes mënyrës elektronike me e-mail, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar, komisioni nuk do të miratojë pjesëmarrjen në ankandin publik për çka do të informojë përmes formës elektronike për shkak të refuzimit.

3. Ankandi do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

4. Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se thirrjes së shpalljes i përgjigjet vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në shpallje.

5. Ankandi publik do të fillojë me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht ta rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandi publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës, gjatë së cilës nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë të re.

6. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohorë prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të të ankandit publik nuk pranohet oferta, gjegjësisht nuk jepet ofertë më e lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste ulet për 2% pas së cilës pjesëmarrësit në ankandin publik sërish do të kenë mundësinë të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste.

7. Nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të pesë minutave të dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht jepet ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë të re.

8. Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga vlera e përgjithshme e hapësirës afariste. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste gjatë ankandit mund të jetë më së shumti deri në 30% e çmimit të caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht shuma e përgjithshme e vlerësuar për qiranë mujore të objektit afarist nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të parë, pavarësisht sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të dytë, mund të jetë së paku deri në 30% nëse në ankandin publik është paraqitur një pjesëmarrës i interesuar, ndërsa nëse janë paraqitur dy ose më shumë pjesëmarrës, ulja mund të jetë më së

shumti 50% të vlerës së caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht të shumës së përgjithshme të vlerësuar për qiranë mujore të hapësirës afariste.

9. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet deri tek pjesëmarrësit në ankandin publik.

10. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri tek Komisioni, i cili vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës.

11. Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit më të lartë të përgjithshëm, i cili paraqet çmimin më të lartë për qira të objektit afarist.

12. Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje të paguajë mjetet dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare do të aktivizohet ndërsa ofertuesit do të shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

13. Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në afat prej 5 (pesë) ditëve pas pagesës së realizuar të një qirave mujore në shumë të arritur të çmimit në procedurë për ankand publik do të lidhë marrëveshje për qira të hapësirës afariste me ofertuesin më të volitshëm.

14. Tatimi i vlerës së shtuar bie në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

15. Marrëveshja për qira të hapësirës afariste solemnizohet në Noter në barrë të ofertuesit më të volitshëm, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

16. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për qira.

17. Subjektet fizik, subjektet juridik dhe themeluesit i subjektit juridik, i cili në cilëndo bazë ka obligime të papaguara ndaj BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, nuk mund të merr cilësinë e qiramarrësit në BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.

18. Qiramarrësi pas lidhjes së Marrëveshjes për qira në afat prej 7 (shtatë) ditëve duhet të sigurojë Garanci për sigurim të obligacioneve që do të dalin në bazë të marrëveshjes së nënshkruar.

• Shumë të 3 qirave mujore (gjegjësisht të njëjtat të paguhet në xhiro llogarinë e qiradhenësit) ose

• Garanci bankare në shumë prej 3 (tre) qirave mujore.

19. Të gjitha lejet e nevojshme për realizimin veprimtarisë i siguron qiramarrësi. Kjo shpallje do të publikohet në dy gazeta ditore të cilat publikohen në gjuhën maqedonase, ndërsa dalin së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes: NOVA MAKEDONIJA dhe VEÇER dhe një gazetë ditore i cili botohet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit në cilin rajon gjendet hapësira afariste lëndë e publikimit, ndërsa del së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes – KOHA.

Të interesuarit hapësirën afariste mund ta vizitojnë çdo ditë pune prej ora 10:00 deri në ora 14:00.

Informata më të detajuara mund të merren në selinë e BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në bul. 8-mi Septemvri nr. 13, tel. 02/3089 600.

Personat për kontakt:

Oliver Kitanovski 076/361176 e-mail: oliver.kitanovski@scboristrajkovski.gov.mk (për çështje juridike)

Lupço Tomovski 076/361184 e-mail: lupco.tomovski@gmail.com (për çështje të tjera)

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup

Kryetar i komisionit për realizim të procedurave për ankand publik

Robert Teova



DOKUMENTE EKSKLUZIVE

DEKLARATA POLITIKE E KUVENDIT TË PARTISË DEMOKRATIKE POPULLORE

Ky definicion i shtruar në mënyrë të hapur nga udhëheqja e atëhershme e Partisë Demokratike Popullore, nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuar brenda të ashtuquajturës "Qeveri të ekspertëve" (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti

Qerim LITA

Më 19 qershor të vitit 1991, gazeta "Nova Makedonija", botoi Deklaratën politike të njëres ndër dy partive të atëhershme shqiptare, Partisë Demokratike Popullore, ku veç tjerash në të thuhej se "PDP-ë është përcaktuar që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i pranohet statusi i kombit", edhe atë si "shprehje e lirisë dhe të drejtës për përcaktim të lirë nacional, për vetëvendosje dhe me të drejtë të shkëputjes nga robëria totalitare e asimiluese pan-sllaviste...". Ky definicion i shtruar në mënyrë të hapur nga udhëheqja e atëhershme e Partisë Demokratike Popullore, nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuar brenda të ashtuquajturës "Qeveri të ekspertëve" (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti. Është me rëndësi të theksohet se një deklaratë e tillë erdhi si rrjedhojë e refuzimit të kërkesave të pareshitura të shqiptarëve nga udhëheqja e atëhershme maqedonase, të cilat përfshiheshin në disa pika, në radhë të parë në përmirësimin urgjent të statusit të tyre i cili ishte tepër degradues dhe ofendues "pakicë nacionale".

Përveç kësaj, shqiptarëve ju mohohet e drejta e shkollimit në gjuhën amtare (përveç shkollimit fillor) e shumë të drejta tjera të cilat



gjatë periudhës kohore 1986-1990, ku siç është e njohur botërisht, udhëheqja e atëhershme komuniste maqedonase në krye me Jakov Lllazarovskin e Millan Pançevskin, i ndërmori në emër të "rënjosjes së nacionalizmit e separatizmit shqiptar-madh". Për të parë më së afërmi se çfarë thuhej në Deklaratën Politike të Partisë Demokratike Popullore, të njëjtën në vazhdim po e paraqesim në tërësi, e cila siç u tha më lartë u botua nga "Nova Makedonija" më 19 qershor të vitit 1991.

"Duke u nisur nga përcaktimet programore, nga situatat dhe rrethanat në Maqedoni e në Jugosllavi për shkak diskriminimit dhe injorimit e të drejtave kombëtare, kombi shqiptar në Jugosllavi për shkak armiqësisë dhe jotolerancës katastrofale midis kombeve, për shkak mohimit të shqiptarëve si komb në Jugosllavi dhe si subjekt i barabartë për vetëvendosje, Partia Demokratike Popullore, për ta aktualizuar realitetin në Maqedoni, e miratoi Deklaratën Politike me sa më poshtë vijon:

1. Partia Demokratike Popullore si moto të përcaktimit programore të veta e ka realizimin e të drejtave dhe lirisë kolektive e individuale të kombit shqiptar në Jugosllavi. Realizimi i të drejtave globale do të jetë platforma e sigurt për realizimin e të drejtave individuale të qy-

etarëve.

Të drejtat dhe liritë e kombit shqiptar në Jugosllavi duhet të jenë të garantuara me Kushtetutë. Për atë garanci, barazia parimore e qytetarëve, realisht është e përealizueshme.

2. PDP-ë është përcaktuar që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i pranohet statusi i kombit (janë mbi 3 milion) edhe atë si shprehje e lirisë dhe të drejtës për përcaktim të lirë nacional, për vetëvendosje dhe me të drejtë të shkëputjes nga robëria totalitare e asimiluese pan-sllaviste.

3. Bartës i sovranitetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë të jetë kombi shqiptar që jeton në Maqedoni edhe atë i përcaktuar dhe i emëruar si kolektivitet kombëtar, e jo si qytetar, nga arsytet se realizimi institucional i të drejtave kolektive kombëtare përbën mjet efikas për ndërprerjen e diskriminimit nacional nga njëra anë dhe mbrojtje dhe kultivimi i veçorive që i karakterizojnë në kuptimin pozitiv nga ana tjetër.

4. Republika e Maqedonisë të jetë shtet i pavarur dhe sovran, shtet demokratik, me pluralizëm partiak (si garanci të demokracisë reale) me zgjedhje demokratike të lira e parlamentare, pa majorizim nacional dhe në radhë të parë shtet juridik e i çliruar nga filozofia bolshevik-marksishte-leniniste, ideologji e cila kombin shqiptar e largoi

nga komponenta fetare, me çka e varfëroi qenien e tij nacionale dhe këtë qenie për 45 vite me radhë e orientoi kah pansllavizmi.

Shqiptarët edhe më tej anashkalohe nga "Samiti-Jugosllav". Shqiptarët duhet të konsiderohen si element konstituiv të lirisë për sistemin e ri shtetëror.

PDP-ë nuk do t'i pranoj vendimet e "Samitit - Jugosllav" pa shqiptarët. Zgjidhjen do ta kërkoj në bashkimin mbarëkombëtar dhe formimin e një shteti të vetëm shqiptar në Ballkan.

Arena ndërkombëtare Jugosllavinë ende e dëshiron si status-kuo, që paraqet grusht të rëndë kundër integritetit të shqiptarëve në Jugosllavi, në rrjedhat demokratike, por edhe të tjerëve të cilët shqiptarëve ua mohojnë të drejtën për vetëvendosje.

5. Jemi të përcaktuar për zhvillim të gjithanshëm dhe kultivim dhe zhvillim të pavarur të arsimit, kulturës, të shkencës, e sidomos të historisë sonë kombëtare, tërë kjo e ngritur në shkallën e organizimit institucional.

Shqiptarët në Jugosllavi janë të diskriminuar nga hegjemonistët serb e maqedonas në lidhje me themelimin e institucioneve arsimore-shkencore në gjuhën shqipe, për arsye se, përmes këtyre institucioneve do të zbulohet e kaluara dhe e tashmja e hidhur, e vërteta për ma-

sakrën e kryer në monopolin e Tetovës, në shkollën bujqësore në Tetovë, për marrshin e vdekjes në bregdetin Adriatik, të shqiptarëve pastrues të minave në Frontin e Sremit, për vrasjet masive në Kosovë, për terrorin shtetëror e institucional të APJ-së, për pushtimin ushtarak-politor, për gjenocidin mbi kombin shqiptar...

6. Tërë ky përcaktim do të arrihet nëse e realizojmë të drejtën e plotë për shkollim në gjuhën shqipe me ndryshimin e plan-programeve mësimore të imponuara, veçmas mësimin e historisë kombëtare e tjerë.


Pushteti maqedonas në vend të progresit e zgjedhi regresin. Janë bërë dhe po bëhen shumë reduktime e ndalime për shkollim në gjuhën shqipe, janë miratuar ligje diskriminuese në fushën e shkollimit, u mbyllën shumë shkolla të mesme në gjuhën shqipe, na urdhëruan të mësojmë në "paralelet e përziera", administratën pedagogjike ta udhëheqim në gjuhë të huaj, sollën vendime për shkollim të mesëm të imponuar vetëm në gjuhën maqedonase...

Kërkesat gjithë-shqiptare për mësim në gjuhën shqipe injorohen nga "shteti demokratik". Pasiviteti shtetëror, që i përket shkollimit në gjuhën shqipe, paraqet një politikë aktive të denacionalizimit dhe asimilimit të kombit shqiptar.

7. Ne jemi për komunikim të lirë dhe për integrim të mendimeve, të ideve, të kuadrit dhe të arriturave shkencore-teknike e teknologjike, duke mos i marr parasysht kufijtë shtetëror. Kufijtë të jenë vetëm sinjal për shënimin administrativ shtetëror.

Për koordinimin dhe sistemin të synimeve mbarëshqiptare në Jugosllavi, nevojitet bashkëpunimi i ngushtë midis partive politike e të shoqatave tjera shqiptare, me orientim demokratik në Jugosllavi e Shqipëri. Që ky bashkëpunim të funksionoj, duhet të iniciohet themelimi i parlamentit mbarëshqiptar, si bartës i platformës mbarëshqiptare dhe koordinator i bashkëpunimit midis partive politike shqiptare dhe partive dhe asociacioneve tjera ndërkombëtare për aktualizimin e çështjes shqiptare, për integrimin e përgjithshëm të shqiptarëve me proceset evropiane.

PS. Të premtet e ardhshme do ta botojmë reagimin e Ministrisë për Informim të Qeverisë së RM-së, lidhur me publikimin e Deklaratës Politike të PDP-së.



Fatmira NIKOLLI

Si për të hequr çdo njollë e hije mbi Akademinë e harruar të 1937-ës, profesor Aurel Plasari, zbuloi edhe statutin e saj. “Për të mirën e historisë, Statuti i Akademisë Albanologjike Saveriane është ruajtur. Ai mund të konsultohet në dy ekzemplarë që ndodhen: njëri në AQSh dhe tjetri në bibliotekën ‘Marin Barleti’ të Shkodrës, i riproduhuar edhe për Arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Në ballinë Statuti mban stemën me shënimin rrethor: “Akademia Albanologjike Xaveriane”, -tha Plasari, pasi kish renditur ndër kushtet për themelimin e një akademie të tillë albanologjike ndikimin e valës që kishin marrë në mënyrë progresive, në vende të zhvilluara të Europës, ato që quheshin në atë kohë “studime shqiptare”.

STATUTI DHE ORGANIZIMI I AKADEMISË


Në krye shkruhet “Academia Albanologica Xaveriana. Concordia Parvae Res Crescunt”. Sipas tij, motoja latine është po ajo që e ka mbajtur për shumë vite edhe revista “Leka” dhe që vetë saverianët e jepnin në shqip “Sendet e vogla rriten prej bashkimit” ose “Punët e vogla me bashkim rriten”. Në të vërtetë, sipas Plasarit, e plotë thënia latine është “Me marrëveshje gjërat e vogla rriten, me mosmarrëveshje edhe të mëdhatë zvogëlohen”. Neni i parë i Statutit të Akademisë në fjalë përcakton: “I- Akademia Albanologjike Saveriane jeton në gjë të shoqatës L.E.K.A., t’ish nënansavet të Kolegjit Historike Saveriane, botuese të revistës “Leka”. Sipas Plasarit, leximi i këtij neni të parë është vendimtar për të kuptuar që si de jure, si de facto, Akademia në fjalë nuk ishte strukturë e Urdhrit Jezuit, por e shoqatës L.E.K.A., e cila si themelimi dhe si përbërje u përshkrua. Ndërkaq, qëllimi parësor i themelimit të Akademisë në fjalë, i shpallur në nenin II të Statutit të

saj, përbën njëherësh edhe një përkufizim të fushës së albanologjisë që ende sot mund të kihet zili për nga konceptimi: “II. Qëllimi i sái me u dhënë shkës e me u ndihmue n’atë të veten gjithë atyne studimeve qi permblidhen në rreth t’albanologjis, d.m.th. qi i perkasin historis, gjeografis e humlumtimevet e aplikacionevet fizike-natyrore, letërsis, gjuhësis, folklorës e artevet të bukra të vendevet qi janë o kanë këne shqiptare, si atdhë o si koloní, të fisit shqiptár. E prandej synon me mbledhë tok në bashkupim të gjith ata albanologj shqiptarë e të huej qi kërkojnë me dhënë e me nxjerrë, nder kerkime të veta, ndimen vëllaznore të nierzvet kompetentë të shperdam në qandra kulturore të ndryshme. Qëllimi i fundshem: me përhapë njoftimin e çëmimin e Kómbit Shqiptár fisnik”. Plasari shënon se neni III përcakton ndarjen në degët të akademikëve duke bërë grupim të dijeve albanologjike si vijon: “1- shqenca morale e filozofike; 2a-shqenca historike, arte e letërsis; 3a-shqenca gjeografike, fizike e natyrore”. “Neni IV përcakton organizimin e akademikëve, anëtarë të Akademisë si dhe bashkëpunëtorë të tjerë, duke mos bërë dallim mes akademikëve rezidentë dhe 14 akademikëve korrespondentë. Kourumi i tyre i mjaftueshëm është tridhjetë të tillë me të drejtë vote. Po ashtu Akademia ka edhe dhjetë anëtarë nderi. Në fondet arkivore të Ndre Mjedës në AQSh është ruajtur një dokument disafish i çmuar: diploma e tij si anëtar i Akademisë”, tha profesor Plasari. Ai bëri me dije se përpos saverianëve të mirëfilltë, Akademia ka pasur edhe të tjerë anëtarë, shekullarë dhe laikë. Ndër këta të fundit Zamputi kujtonte Kolë Kamsin që është quajtur drejt “pionier i studimeve arbëreshe në Shqipëri”, Ilo-Mitkë Qafëzezin që botoi në “Leka” punimet e tij për Voskopojën, Lumo Skendon me vrojtime të tij albanologjike, Lukë Kara-

STATUTI I AKADEMISË MË 1937

“ME Mbledhë TOK ALBANOLOGJË SHQIPTARË E TË HUEJ”

Nuk mund të mos pohohet që themelimi i Akademisë Albanologjike më 1937 të ketë qenë aspirata e fundit e realizuar, atdhetare dhe njëherësh shkencore, e Mjedës i cili do të vdiste më 1 gusht të po atij viti



filin (Bardhyli) me vargun e punimeve për historikun e bibliotekave në Shqipëri etj. Ia vlen, -tha Plasari, të përsëritet që baza e Akademisë Albanologjike të saverianëve, ashtu si edhe e revistës “Leka”, ishte dhe mbetej shoqata L.E.K.A., e themeluar më 1928 nga 38 absolventët e Kolegjit Saverian dhe shkollave të tjera, pra kryesisht laikë dhe pa dallim përkatësie fetare. Në mungesë të një liste të plotë të anëtarësisë si akt dokumentar, kërkimet për të do të duhen vijuar.

Neni V i Statutit sqaron mbi organet drejtuese të Akademisë: “Akademia ka NJI KRYETAR LIGJUER PERGJEGJËS, i cili është de jure vetë Drejtori Pergjegjës i revistës “Leka”, të cillit i njehet se i është mbarë veprimi kulturor i shoqatës “L.E.K.A.”. Këti i ipet si zbatues e si organizues NJI DREJTUES TEKNIK, i cili de jure është vetë Drejtori Pergjegjës i Kolegjit Saveriane. Çdo degë ka edhe DREJTUESIN e vet. Akademia ka edhe një SEKRETAR të zgjedhur prej Kryetarit Pergjegjës nder Akademikë o nder Antarë; ky vepron edhe si sekretar i degvet të ndryshme”. Plasari tha se pas verifikimit rezultoi që si kryetar i AAS nënkruante Zef (Pashko) Naraçi S. J., njëherësh edhe drejtor

përgjegjës i revistës i “Leka”-s, ndërsa si drejtues teknik nënkruante Zef Valentini.

MJEDA I VETIZOLUAR

Mund të pyetet, në këtë rast, për pozicionin e Ndre Mjedës, “frymëzuesit” të kësaj Akademie, -tha Plasari, duke u përgjigjur se “një dalje e tij në krye të Akademisë në fjalë do të ketë qenë organizativisht e papërshtatshme. Ndonëse Akademia vepronte ‘në gjë’ të shoqatës L.E.K.A., pra të absolventëve të Kolegjit të Shën Ksaverit dhe të kolegjeve a shkollave të tjera, Mjeda vijonte gjithnjë të mos bënte pjesë në bashkësinë jezuite duke qenë i dalë jashtë Urdhrit përkatës, edhe kur që i integruar si mësimdhënës në atë Kolegji”. Plasari kujtoi se ka rëndësi të kuptuarit e pozicionit të tij social dhe të tërheqjes së tij nga jeta publike, - vetë Mjeda ka pohuar në një rast që nuk ishte në natyrën e tij angazhimi publik- sidomos në atë moshë dhe në atë ndërkohë zhgënjimesh të jetës së tij. “Të tillë e njohu Injac Zamputi mësuesin e vet në vitet e fundit të jetës, sikundër edhe ia përshkroi ‘karakterin e tij të drojtur, që e bënte më të shumtën të ishte i vetmuar’. Për Zamputin ‘ishte kryesisht poet dhe studimtar, nuk kishte komunikativë oratorie’, -tha Plasari. Zamputit i ka bërë përshtypje që mësuesit të shkuar nga mosha i pëlqente më fort të mos kishte takime të shpeshta me njerëz; edhe rrugës përherë dilte vetëm, kryesisht për të shkruar në Arkiveshkví, tek i vëllai Lazër Mjeda.

Plasari shtoi se kush lexon kujtimet dhe përshtypjet e ish nxënëseve të tij - gjithë respekt dhe admirim për mësuesin - do të ndeshë jo nga një, por nga disa syresh konstatim që mësuesi i tyre “ishte i vetizoluem”, “rronte i vetizoluem”. “Izolim vullnetar”, e ka përcaktuar Zamputi. “Na pleqtë nuk i kemi ma hovet rinore”, i është mirëbesuar ai në një moment dishepullit të vet.

“Por Zamputi duket të ketë të drejtë kur këtë dukuri të karakterit ia ka detyruar të kaluarës së tij, kur rrethi i bashkëpunëtorëve i kishte shkaktuar veprës dhe personit të Mjedës shumë mosmarrëveshje, kundërshtime, keqkuptime. Prandaj Mjeda, gjatë atyre viteve të fundit, edhe pse duke qenë në kulmin e pjekurisë së tij intelektuale, kishte zgjedhur ta kalonte ‘në qetësi’ kohën që i kishte mbetur. Do të duhet shtuar që Mjeda i atyre viteve ishte edhe i përsyshur politikisht: në Shqipëri mbretëronte Ahmet Zogu, armik i tiji i vjetër, që e kishte burgosur dhe internuar dikur. Gjithsesi nuk mund të mos pohohet që themelimi i Akademisë Albanologjike më 1937 të ketë qenë aspirata e fundit e realizuar, atdhetare dhe njëherësh shkencore, e Mjedës i cili do të vdiste më 1 gusht të po atij viti”, theksoi Plasari.

Nenet VI, VII, VIII dhe IX të Statutit të Akademisë përsaktësojnë detyrat dhe të drejtat e drejtuesve. Në ligjëratën e tij, Plasari bëri me dije se me ardhjen e pushtimit fashist, Akademia u mbyll. “Kjo veprimtari nuk ka qenë e lehtë kuptohet, për shembull, nga vargu i akteve administrative me të cilat Zyra shtetërore e censurës është orvatur ta pengojë më 1938 botimin e përmbledhjes me dokumente për Lidhjen e Prizrenit, e cila ka mundur të qarkullonte vetëm në fillim të vitit 1939”, tha ai. Plasari vërejt se e para dhe më e rëndësishmja vepër e kësaj Akademie Albanologjike ishte vetë ekzistenca e saj. Shpërfillja që iu bë AAS-së ka pasur të bëjë me një zgjedhje ideologjike të organizimit të “studimeve shqiptare”. Valentini, tha Plasari, e pranoi kompromisin të përfshihej në atë strukturë të re. “Si italian i mirë dhe njëherësh si albanofil i mirë, duhet t’i ketë bërë llogaritë me parimin ‘me shpëtue të shpëtueshmen’ dhe me vullnetin për të nxjerrë në dritë një numër veprash që qenë prej vitesh në proces”. (bv)

BESART BERISHA FLET PAS RINOVIMIT TË KONTRATËS
ME MELBURN VIKTORI

DUA TË VAZHDOJ TË SHKRUAJ HISTORINË ME KËTË KLUB

“Besimi që kam te trajneri Kevin, stafi teknik dhe klubi kanë qenë arsye të mëdha se pse vendosa ta vazhdoja kontratën. Unë e shijoj sfidën duke u munduar të jem më i miri. Klubi dëshiron të jetë më i miri, unë dua të jem më i miri. Dua të vazhdoj ta shkruaj historinë me këtë klub”, pohon Berisha



Kevin Muskat

Besart Berisha ka vendosur përfundimisht për të ardhmen e tij. Në fakt përfaqësuesi kosovar i ka hequr të gjitha dyshimet pas një kohe bisedimesh dhe karriera e tij do të vazhdojë në futbollin australian. Prishtinasi do ta udhëheqë sulmin e Melbourne Viktori deri në vitin 2019, pasi e ka vazhduar kontratën me këtë klub për një vit, shkruan gazeta Zëri. “Besimi që kam te trajneri Kevin, stafi teknik dhe klubi kanë qenë arsye të mëdha se pse vendosa ta vazhdoja kontratën”, është shprehur fillimisht Berisha. “Unë e

shijoj sfidën duke u munduar të jem më i miri. Klubi dëshiron të jetë më i miri, unë dua të jem më i miri. Dua të vazhdoj ta shkruaj historinë me këtë klub”, ka shtuar sulmuesi kosovar, i cili mësohet se ka pranuar t’i zvogëlohet rroga vetëm për të qëndruar në Viktori. Berisha është golashënuesi më i mirë i kampionatit australian këtë sezon me 9 gola, përpara Arçi Tompson, që ka gjashtë. Në anën tjetër trajner i Melbourne, Kevin Muskat, është i lumtur që do ta ketë në dispozicion Berishën edhe sezonin e ardhshëm. “Rekordet e Besit flasin

Rekordet e Besit flasin vetë dhe ne jemi të lumtur që do ta kemi atë edhe sezonin tjetër. Kontributi i tij në klub në tre vjet e gjysmë ka qenë impresionues dhe domethënës, ndërsa ne mezi presim të shijojmë shumë gola të tjerë nga ai në të ardhmen

vetë dhe ne jemi të lumtur që do ta kemi atë edhe sezonin tjetër. Kontributi i tij në klub në tre vjet e gjysmë ka qenë impresionues dhe domethënës, ndërsa ne mezi presim të shijojmë shumë gola të tjerë nga ai në të ardhmen”, deklaroi



qëkur ishte transferuar nga Brisbane Roar në vitin 2014, për të arritur në 106 gola në kampionatin australian që prej vitit 2011, kur ishte transferuar tek “Kangurët” nga Arminia Bielefeld. Përfaqësuesin kosovar e kërkoi skuadrat nga Japonia dhe nga vendet e tjera të Azisë, por Viktori e menaxhoi mirë situatën për ta mbajtur atë. Berisha po ashtu mund ta marrë pasaportën australiane me kohë për sezonin tjetër, gjë e cila do t’ia mundësonte Melbourne që ta marrë një tjetër futbollist të huaj.



Kasami beson në ringjalljen e Sionit

Skuadra e Sionit këtë edicion ka treguar rezultate të dobëta. Renditet në pozitën e fundit në tabelë, me 17 pikë të mbledhura pas 19-të xhironë të zhvilluara. Kapiteni i ri i Sionit, Pajtim Kasami, thotë se nuk është nevoja për panik me gjithë situatën e krijuar, përcjell “Blick” të mërkurën. Madje ai insiston se është më se i motivuar dhe me bindje të plotë insiston se Sioni do të mbetet në elitën e futbollit zviceran edhe edicionin e ardhshëm. “Duhet pranuar se situata është shumë e vështirë, por nuk ka nevojë për panik. Është edhe pjesa tjetër dhe besoj se Sioni pa problem edhe edicionin tjetër do të luajë në elitë”, është shprehur Kasami. “Të them të drejtën, tabelën as që e kam shikuar në javët e fundit, pasi jam i fokusuar për të punuar dhe motivuar ekipin për të dalë nga situata aktuale”, përfundoi Kasami. Sipas tij, Sioni në ndeshjet e fundit nuk ka luajtur keq, por gabimet e shumta kanë bërë që ekipit “t’i ikin” fitoret nga duart

ADILI LARGOHET NGA UTA ARAD

VAZHDOJNË BISEDIMET ME SHKËNDIJËN

Shkup, 21 dhjetor - Mevlan Adili nuk do të jetë më futbollist i UTA Arada nga Rumania, bën të ditur gazeta KOHA.

Këtë vendim mbrojtësi shkupjan e ka sjell sot, derisa në profilin e tij zyrtar në “Facebook” ka falënderuar tani më ish-klubin e tij, drejtuesit, stafin teknik, lojtarët dhe futbollist.

“Pas bisedimeve që pata me kryetarin e klubit vendosëm të ndërprej bashkëpunimin para kohe.



Kisha edhe gjashtë muaj kontratë por ja që me marrëveshje të njëjtën siç thash po e ndërprej para kohe”, u shpreh Adili. “Sinçe-

risht njëherë dua të pushoj dhe më pas do të vendos se çka do të bëj. Kuptohet kjo punë është e menaxherit tim Meriton Berisha dhe bashkërisht do të vendosim për të ardhmen time”, deklaroi për KOHA, Adili.

Cekim, para disa ditë menaxheri i mbrojtësit shkupjan Meriton Berisha për gazetën KOHA konfirmoi se janë në bisedime me KF Shkëndija dhe ekziston mundësia që futbollist i tij të vesh sërish fanellën kuqezi.

RENDITJA E FIFA

MAQEDONIA DHE SHQIPËRIA NUK NDRYSHOJNË POZITAT

Shkup, 21 dhjetor - FIFA ka publikuar renditjen e re të reprezentacioneve, ndërsa Maqedonia nuk ka lëvizur asnjë pozitë, duke e mbyllur vitin në pozitën e 76-të. Ndryshe, edhe Kombëtarja e Shqipërisë nuk ka lëvizur, dhe në renditjen më të re ka mbetur në pozitën e njëjte sikurse ishte muaj më parë, në pozitën e 62-të. Derisa, përfaqësuesja e Kosovës ka rënë nga pozita e 174 në 177 në renditjen e re të shtëpisë më ta madhe të futbollit në botë, FIFA. Në renditjen e



përgjithshme Gjermania vazhdon të jetë më e mirë, e ndjekur

nga Brazili, Portugalia, Argjentina, Belgjika, Spanja, Polonia,

Zvicra, Franca, ndërsa dhjetëshen e parë e mbyll Kili.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Tekst i pastruar (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 145/2014) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 15/11, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14) Pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-11102/3 të datës 05.12.2017 dhe Pëlqimit nr. 12-14460/2 të datës 11.12.2017, Vendimit të drejtorit për publikim të shpalljes publike nr. 02-421/1 të datës 20.12.2017, drejtori i SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë, Komuna Novo Sellë, publikon:

SHPALLJE

Për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 për vendet e punës në vijim:

1. Një mësimdhënës të etikës me orar jo të plotë të punës – 4 orë mësimore.
2. Një mësimdhënës të kulturës klasike të civilizimit evropian]me orar jo të plotë të punës – 2 orë mësimore.
3. Një mësimdhënës të artit figurativ me orar jo të plotë të punës – 8 orë mësimore.
4. Një mësimdhënës – projektet e artit figurativ me orar jo të plotë të punës – 4 orë mësimore
5. Një mësimdhënës të informatikës me orar jo të plotë të punës – 6 orë mësimore
6. Një mësimdhënës të mësimin klakor në SHFP Mokrino
7. Një mësimdhënës të mësimin klakor në SHFP Mokrino – zëvendësim të drejtorit
8. Një mësimdhënës të arsimin teknik me orar jo të plotë të punës – 8 orë mësimore.
9. Një mësimdhënës të gjuhës angleze me orar jo të plotë të punës – 8 orë mësimore.
10. Një mësimdhënës të kimisë me orar jo të plotë të punës – 8 orë mësimore
11. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me orar jo të plotë të punës – 12 orë mësimore.
12. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me orar të plotë të punës.
13. Një mësimdhënës të gjuhës angleze në mësim klakor me orar ko të plotë të punës – 18 orë mësimore – në bazë pushim mjekësor
14. Një mësimdhënës të gjeografisë me orar jo të plotë të punës – 16 orë mësimore.

Të gjitha vendet e lartpërmendura të punës janë për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2017 (për mësimdhënës në pushim mjekësor – deri në kthimin e punëtorit nga pushimi mjekësor).

Orari i punës së kuadrit mësimor në shkollë: për ndërrimin e parë prej ora 07,00 deri në ora 13,00, Neto pagesa bazë për mësimdhënës me orar të plotë të punës është 20.640 denarë, ndërsa për vendet e punës me fond më të vogël të orëve mësimore është në pajtim me numrin e orëve mësimore të mësimdhënësit.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP duhet të përmbushen edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim fillor:

- Të kenë të mbaruar arsim përkatës
- Të jenë shtetas të RM
- Të njohin gjuhën letrare maqedonase dhe alfabetin cirilik.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 8 ditëve, nga kalimi i afatit për paraqitje, ndërsa lutjet me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrihen në arkivin e SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë. Informacione në tel. 034/351-290.

SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë
UD Drejtor,
Sllagjana Radojčić

Në bazë të nenit 22 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare nr. 62/2005) dhe neni 80 prej Ligjit për arsim fillor, SHF “Bratstvo Edinstvo” f.Konjare e Mesme shpall

KONKURS PUBLIK

për punësim për kohë të caktuar në pozitën:

1. Një arsimtarë i grupit klakor në gjuhën shqipe, me 40 orë mësimore në javë- rroga neto 20.644,00 denarë.
2. Një arsimtarë të grupit klakor në gjuhën maqedonase me 40 orë mësimore - rroga neto 20.644,00 denarë.
3. Një arsimtarë i biologjisë me 36 orë mësimore në javë- rroga neto 19.187,00 denarë.
4. Një arsimtarë i gjuhës dhe kulturës boshnjake me 40 orë mësimore në javë- rroga neto 20.644,00 denarë.
5. Një mësimdhënës të matematikës për mësimin në gjuhën shqipe me 40 orë mësimore në javë – rroga neto 20.644,00 denarë.

Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet në vijim:

- të jenë shtetas të R.Maqedonisë
- të kenë mbaruar arsim të lartë përkatës.
- dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim mbi ndalimin e ushtrimit të profesionit, të veprimtarisë ose të detyrës
- të jetë i ritur
- të ketë shëndet të mirë për vendin e punës
- të ketë kaluar provim profesional për arsimtarë
- ta njohë gjuhën maqedonase dhe të shkruar. (për personat të cilat ligjorin në paralelet në gjuhën shqipe përveç gjuhës maqedonase duhet ta njohin dhe gjuhën në të cilën mbahet mësimi).

Orari i punës është prej të hënës deri të premtën prej ora 7 deri në ora 13.

Konkursi zgjat 5 ditë pune

Përzgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditës pas skadimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet të dorëzohen në arkivin e shkollës apo në adresën: SHF Bratstvo Edinstvo f.Konjare e Mesme-Petrovec

Në bazë të nenit 126 pika 1 alineja 7 neni 128 pika 3 e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër (103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17), në pajtim me nenin 71 të Statutit të shkollës dhe vendimit nr. 02-316/2, Këshilli i shkollës së SHFK “Sv. Kliment Ohridski” f. Drasllajca – Strugë publikon:

SHPALLJE

Për zgjedhje të drejtorit të shkollës fillore

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligi, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore, të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore, të kenë të dhënë provimin për drejtor, në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Kandidatët krahas lutjes me biografi të shkurtë, të parashtrorin dokumentet në vijim: Diplomë për arsim të mbaruar, vërtetim për përvojën e punës në punë edukativo-arsimore, certifikatë të shtetësisë, certifikatë për provim të dhënë për drejtor, certifikatë – vërtetim se nuk është i dënuar, certifikatë – vërtetim për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet dhe Program të punës së shkollës për periudhë prej 4 vjet.

Vendi i punës është me autorizime të posaçme dhe është për kohë të caktuar 4 vjet.

Orari i punës 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 7 deri në ora 15. Pagesa bazë 25.733 denarë.

Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Vendimi për zgjedhje do të realizohet në pajtim me Ligjin për arsim fillor ndërsa më së voni në afat prej dyzetepesë ditë.

Dokumentet e pakompletuara si dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Lutjet së basku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën: SHFK “Sveti Kliment Ohridski” f. Drasllajca Strugë – Këshilli i shkollës me shenjë për shpallje të publikuar për drejtor.

SHFK “Sveti Kliment Ohridski” f. Drasllajca
Këshilli drejtues

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtor nr. 04-1198/1 të datës 05.12.2017, neni 34 të Statutit të NP Komunalec Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes

Publikon SHPALLJE Për pranin të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranin të punëtorëve për kohë të caktuar për 9 (nëntë) muaj edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. Punëtor për mënjanimin e mbeturinave në NJR Higjiena dhe gjelbërimi – 5 (pesë) realizues;

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PKU, shkalla e I e përgatitjes profesionale;

Kandidatët krahas lutjes për punë të parashtrorin edhe dëshmi për arsimin e mbaruar si dhe dokument me çka përmbushë kushtet e posaçme të theksuara më lartë.

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 60 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë prej 90 ditë, mbi 500 kandidatë prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në arkivin e NP Komunalec – Kavadar, rr. “Industriska” pn.

NP Komunalec – Kavadar
UD Drejtori
/Jurist i diplomuar I. Atanasov/

KORIGJIM

Në shpalljen publike të SHMEJQSH “Vasil Antevski-Dren” Shkup e botuar në gazetën Koha me 21.12.2017 për plotësimin e vendeve të punës me kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018 për mësim në maqedone është bërë gabim edhe atë: në pikën 2 të shpalljes mësimdhënës të gjuhës angleze me 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë pune për kohë të caktuar qëndron “deri më 31.08.2017” ndërsa duhet të qëndrojë “deri më 31.08.2018”.

DREJTOR
Aleksandar Kanurkov

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor – Test i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 103/08, 48/09, 53/09, 82/09, 88/09, 33/10, 112/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16 dhe 127/16) dhe Vendimit nr. 09-2821/1 të datës 24.11.2017 të sjellë nga Kryetari i Komunës Novo Sellë, ndërsa në lidhje me nenin 132 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 103/08), Këshilli i Shkollës pranë SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë, komuna e Novo Sellës, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE]

Për zgjedhje të drejtorit të SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

- 1 Të ketë të mbaruar së paku arsimin sipëror;
2. Të përmbushin kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore;
3. Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimor;
4. Të ketë të dhënë provim për drejtor;
5. Të ketë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.
6. Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
7. Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen kandidati duhet të parashtrorin dokumentet në vijim se i përmbushin kushtet e lartpërmendura.

- dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës sipëror,
- dëshmi për përvojën punës,
- certifikatë të shtetësisë,
- certifikatë për provim të dhënë për drejtor, test psikologjik dhe test për integritet
- program të punës për periudhë prej 4 (katër) vjet.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 132 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 103/08).

Kandidatët të parashtrorin dokumentet në vijim deri tek Këshilli i shkollës pranë SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë, komuna Novo Sellë. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrorin pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

20.12.2017 Këshilli i shkollës pranë SHFK “Vidoe Podgorec” – Koleshinë
Kryetar,
Liljana Pockovska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 167/15- tekst i reduktuar) dhe neni 59,60 dhe 92 nga Ligji arsim të mesëm (gazeta zyrtare e RM-së 24/96, 34/96,.....98/15 dhe 30/16) Shkolla e mesme e bujqësisë dhe pylltarisë “Gjorçe Petrov” Kavadar, shpall:

KONKURS:

për të siguruar nevojat e punëtorëve

1. Një arsimtar për sport dhe aktivitete sportive me orar të plotë - paga neto bazë 21.534,000 den.
2. Një defektolog me orar të plotë - paga neto bazë prej 21.534,00,00 den.

Vendet e punës janë për një kohë të caktuar deri më 31.08.2018

Kushte:

Kandidatët e paraqitur ti plotësojnë kushtet vijuese:

1. Kandidatët nën numrin 1 të kenë të kryer fakultetin e Kulturës Fizike (shkalla VII apo 240 EKTS) sipas normativave për mësimdhënës
 2. Kandidatët nën numrin 2 të kenë të kryer fakultetin filozofik - studime për defektologji
- Orari i punës për vendin e 1 të punës është përcaktuar në përputhje me orarin e mësimin nga ora 07-13, për defektolog orari i punës është me prej të hënës deri të premtën prej orës 07-15.
- Kandidatët për vendin nën num. rend. 1 dhe 2 të punës duhet ti plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme nga LMP dhe kushtet e posaçme nga Ligji për arsim të mesëm.
- Aplikacionet së bashku me dokumentet e kërkuara (të notariuara) të dorëzohen në afat prej 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të konkursit nga SHMBP “Gjorçe Petrov” Kavadar, rr. “Shishka nr23, 1430 Kavadar. Me kandidatët në num. rend. 1 të punës të cilët i plotësojnë kushtet, ndërsa më parë nuk janë testuar do të kryhet intervistë dhe verifikim i posedimit të njohurive të gjuhës letrare maqedonase. Zgjedhja do të bëhet në afat prej 5 ditë nga skadimi i afatit për aplikime. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jo në kohë nuk do të merren parasysh.

SHMBP “Gjorçe Petrov”
Kavadar

Universiteti “Shën Kliment Ohridski” – Manastir Fakulteti për siguri – Shkup

LAJMËRIM

Mbrojtja publike të disertacionit të doktoratës nga kandidati **m-r Goce Anakievski** me titull:

“Aspektet metodike të hulimitit të materieve shpërthyes në Republikën e Maqedonisë në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011”

do të mbahet më datë 29.12.2017 (e premte) me fillim në ora 11:00, në Fakultetin për siguri – Shkup, rr. “1” Kolonia Idrizovë nr. 2A – Shkup, në lokalet e bibliotekës.

FAKULTETI PËR SIGURI
SHKUP

Koha, e premte 22 dhjetor, 2017

JAIME SHKURT

PSZH ia mbyll dyert
Donnarummas

Nuk do të jetë në Francë e ardhmja e Donnarummas. Drejtori Sportiv i PSZH, Antero Henrikue hodhi poshtë të gjithë zërat për një kalim të mundshëm të portierit të Milanit, në "Parc Des Princes". "Ai është numri një i portës së PSZH-së dhe skuadra nuk ka nevojë për përforsime në këtë repart", ka thënë Henrikue. PSZH po ashtu në portë e ka edhe portierin gjerman Kevin Trapp.

Uest Hem hyn
fuqishëm në merkato

Uest Hem pritet të bëjë goditje të dyfishtë në merkaton e janarit. Sipas mediave angleze, "Hammers" në sesionin dimëror do të përpiqen të afrojnë në skuadër sulmuesin e Liverpoolit Danni Ings, dhe mesfushorin e Burnmaut, 27-vjeçar Harri Arter. Të dy lojtarët pëlqehen nga trajneri David Mojes dhe janë drejt largimit nga klubet respektive.

MERKATO E INTERIT, PUNOHET NË DY FRONTE

PASTORE KA DHËNË "OK"
PËR TRANSFERIMIN,
PRITET MIKHITARIAN

Interi e ka ndjekur atë prej disa kohësh dhe do të përpiqet ta marrë në janar. Sipas "La Gazzetta dello Sport", Pastore tashmë ka dhënë "OK" për transferimin te zikaltrit, por gjithçka ka të bëjë me Al-Khelaifi, me të cilin nuk është e lehtë të negociohet

Pavarësisht nga fakti se Suning është serioz për investime të mëdha, Interi dëshiron të jetë protagonist i transferimeve të janarit, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e trajnerit Spaletti. Ky i fundit bëri thirrje për përforsime, duke iu drejtuar Ausilios dhe Sabatinit, të cilët punojnë kryesisht në dy fronte dhe posaçërisht në dy emra: Pastore dhe Mikhitarian. Pastore u "zhvendos" në fund të ndeshjes kundër Kaen, ndoshta e fundit me fanellën e PSZH-së. Interi e ka ndjekur atë prej disa kohësh dhe do të përpiqet ta

marrë në janar. Sipas "La Gazzetta dello Sport", Pastore tashmë ka dhënë "OK" për transferimin te zikaltrit, por gjithçka ka të bëjë me Al-Khelaifi, me të cilin nuk është e lehtë të negociohet. Kjo është arsyeja pse Interi është i gatshëm ta vendosë edhe Zhoao Marion në tavolinën e negociatave.

Ndryshe qëndron puna për Mikhitarian. Mançester Junajtedi nuk do të donte ta huazonte armenin, por ndoshta do të ishte më i gatshëm të bisedonte me Borussia Dortmundin, ndoshta në kon-



tekstin e negocimit "Weigl". Në sfond mbetet Ramires, më pak i pëlqyer se dy të parët, por ende ideal për planet e Spaletit. Braziliiani është në pronësi të Jiangsu Suning. Klubi kinez nuk dëshiron t'ia lehtësojë punën Interit me një huazim të lirë. Prandaj, mund të

arrihet një marrëveshje për një transferim të përhershëm, ndoshta për shifra më të vogla. Alternativa me kosto të ulët për mesfushorin është Donsah në Bolonjë, i ri dhe dinamik.

Publicitet

Në bazë të Nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës (Fleta zyrtare e R.M nr. 74/15 Tekst i pastruar) SHFK "Bashkimi" – Gostivar shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

për plotësimin e vendeve të punës në kohë të caktuar deri më 31.08.2018

1. Me mësim në gjuhën maqedone	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gr. klasor (zav. për nën drejtor)	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gr. klasor	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gjuhës Gjermane me plo. në shkollë tjetër	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës të Etikës së reli. me plo. në shkollë tjetër	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gjeografisë me plo. në shkollë tjetër	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gjeografisë	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Projekteve të Informatikës	me fond jo të plotë	10 orë
Një Mësimdhënës Edukimi për mjedisin	me fond jo të plotë	8 orë
Një Mësimdhënës i Gjuhës Angleze	me fond jo të plotë	4 orë
Një Mësimdhënës i Hulumtimi i vendlindjes	me fond jo të plotë	4 orë
Një Mësimdhënës i Historisë	me fond jo të plotë	4 orë
Një mësimdhënës i Arsimi teknik	me fond jo të plotë	3 orë
Një Mësimdhënës i Shkencave natyrore	me fond jo të plotë	2 orë
2. Me mësim në gjuhën shqipe		
Dy Mësimdhënës të Gr. klasor	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Matematikës	me fond të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Gjuhës Gjermane	me fond jo të plotë	8 orë
Një Mësimdhënës i Fizikës	me fond jo të plotë	8 orë
Një Mësimdhënës i Etikës së religjioneve me plot. në shkollë tjetër	me fond jo të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Biologjisë me plotësim	me fond jo të plotë	20 orë
Një Mësimdhënës i Informatikës	me fond jo të plotë	3 orë
Një Mësimdhënës i Matematikës	me fond jo të plotë	5 orë
Një Mësimdhënës i Inovacioneve	me fond jo të plotë	5 orë
Një Mësimdhënës i Arsimi teknik	me fond jo të plotë	3 orë
3. Me mësim në gjuhën turke		
Një Mësimdhënës të Gr. klasor	me fond të plotë	20 orë
• Orari i punës për ndërrimin e parë 07:30 – 13:30		
Orari i punës për ndërrimin e dytë 13:00 – 18:45		
• Vlera e rrogës themelore nën pikën 1, 2, 3 është 20.640,00 denarë		

Kushtet e veçanta:
- Të ketë të kryer arsimin e lartë përkatës
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në shpallje mund të aplikojnë edhe kandidatët që nuk e kanë kryer provimin profesional

Dokumentet e nevojshme:
- lutje
- diplomë në original ose të verifikuar në noter,
- certifikatë e shtetësisë
- vërtetim se nuk është i dënuar jo më i vjetër se 6 muaj
Shpallja zgjat 5 ditë pune nga dita e publikimit. Përgjydhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afat prej 5 ditë pune nga dita e mbarimit të shpalljes së publikuar.
Lutjet me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri të SHFK "Bashkimi" – Gostivar, rr. Pançe Poposki nr. 35, personi për kontakt 078 – 356-917
Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren parasysh.

U.D DREJTOR
VLERA FIDANI

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/2014), dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008) dhe pëlqimit 12-8261/3 nga MASH – Drejtori i SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomila Komuna Çashka më datë 21.12.2017 ka sjellë Vendim për publikim të

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

1. Mësimdhënës të arsimi teknik dhe informatikës një realizues 18 orë në SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomilla.
2. Pedagog me orar të plotë të punës 40 orë pune në SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomilla.
Profesor të gjeografisë dhe kulturës klasike të civilizimit evropian 20 orë më SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomilla.

Kandidatët prej numrit rendor 1 deri në numrin rendor 3 duhet të përmbushin kushtet e parapara në nenin 80 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 51/2011).

Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë pune.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditë pas përfundimit të shpalljes.

Drejtor,
/Pançe Tashkovski/

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 – Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/09, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/15, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016), nenit 34 paragrafi 1 e Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/13), dhe vendimit të Këshillit të Mësimor-shkencor, dekani i Fakultetit të edukatës fizike, sportit dhe shëndetit në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje të

- Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore - shkencore: kinezologia fundamentale, për lëndët: antropomorfika, teoria dhe metodika e fituesit dhe bodibillingut, teknika dhe taktika e fituesit dhe bodibillingut, përgatitja fizike në fitnes dhe bodibilling, praktikë pedagogjike me përgatitje të punës së diplomës

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë: biografi të shkurtër, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është për kohë të caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën: Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçev nr. 3, 1000 Shkup, Fahu P. 681

Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 167/15), neni 60 nga ligji për shkollim të mesëm dhe pëlqimi nr. 12-10914/3 të datës 12.12.2017 nga Ministria për arsim dhe shkencë, SHMK Gjinnazi "Sami Frashëri" Kumanovë publikon:

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës me kuadër mësimor në kohë të caktuar pune deri më 31.08.2018 për vitin shkollor 2017/18.

1. arsimtar të gjuhës shqipe dhe letërsi, Fakultet filologjik (gjuhë shqipe), të dhënë për 20 orë mësimi. Neto page prej 21.500 den.
 - 2.1 arsimtar të hyrjes në drejtësi, fakultet juridik ,me orar të plotë pune. Neto page prej 21.500 den
 - 3.1 arsimtar të sportit dhe aktiviteteve sportive, fakultet të kulturës fizike, për 10 orë mësimi. Neto page prej 11.000 den
 - 4.1 arsimtar të fizikës, Fakultet matematiko-natyror (fizikë), me orar të plotë pune. Neto page prej 21.500 den
 5. 1 arsimtar të psikologjisë, fakultet filozofik të kryer (psikologji), për 10 orë mësimi. Neto page prej 11 .000 den
 6. 1 arsimtar të historisë, fakultet filozofik të kryer (histori), orar të plotë pune. Neto page prej 21.500 den.
 7. 1 arsimtar të gjuhës gjermane, fakultet filologjik(gjuhë gjermane) drejtimi arsimor,për 12 orë mësimi. Neto page prej 13.026 den.
 8. 1 arsimtar të informatikës, Fakultet matematiko-natyror (informatikë)me orar të plotë pune ,neto page prej 21.500 den.
 9. 1 arsimtar të kimisë, Fakultet matematiko-natyror të kryer (kimi) 16 orë mësimi. Neto page prej 16.000 den.
 10. 1 arsimtar të fizikës, Fakultet matematiko-natyror (fizikë), me orar të plotë pune. Neto page prej 21.500 den.
 11. 1 arsimtar të matematikës, Fakultet matematiko-natyror (matematikë), me orar të plotë pune. Neto page prej 21.500 den.
 - 12.1 arsimtar të gjuhës angleze, Fakultet filologjik (gjuhë angleze),për 20 orë mësimi. Neto page prej 21.500 den.
- Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me LMP ti plotësojnë kushtet e parapara në nenin 59 dhe 60 të ligjit për shkollim të mesëm,në përputhje me Normativin e kuadrit mësimor dhe me Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës në shkollë;të kenë kryer shkollim adekuat,të kenë kryer përgatitjen PPM dhe të jenë shtetas të RM-ës.
Shpallja publike zgjat 5 ditë prej ditës së publikimit në mediat publike,kurse zgjedhja do të kryhet në pajtim me nenin 23 alineja 2 nga LMP.

Dokumentet e duhura:lutje,vërtetim për arsimin e kryer,certifikatën e shtetësisë, vërtetim për kualifikim PPM. Dokumentet të dorëzohen në adresë:SHMK "Sami Frashëri"Kumanovë, rr."JNA " pn. 1300 Kumanovë.

Drejtor
Hisen Rahmani

FIFA IA VJEDH IDENË

KËRKON 100 MLN EURO DËMSHPËRBLIM



“Kjo nuk është ‘fair play,’” shprehet ai. Derisa, FIFA nuk ka komentuar mbi konfliktin. Në Kupën e Botës që u zhvillua në Brazil, kompania e tij i dha 300 tuba me sprej FIFA-s që të përdoren nga arbitra

Javën e kaluar, një gjyq në Rio de Zheneiro ka pranuar patentën e Heine Allemagne për sprejin e përdorur nga arbitrat në ndeshjet e futbollit. Gjithashtu kanë urdhëruar FIFA-n të ndalë përdorimin e tyre në kompeticionet e saj. Por prapëseprapë, trupi qeverisës i futbollit e përdori në Kupën e Botës për Klube. Heine Allema-

gne, një shpikës brazilian i pajisjeve sportive, ka folur me “New York Times”, duke theksuar se FIFA i ka vjedhur idenë. “Kjo nuk është ‘fair play,’” shprehet ai. Derisa, FIFA nuk ka komentuar mbi konfliktin. Në Kupën e Botës që u zhvillua në Brazil, kompania e tij i dha 300 tuba me sprej FIFA-s që të përdoren nga arbitrat. Zhero-

me Valcke, ish-sekretari i përgjithshëm i FIFA-s, i ka dërguar një letër Allemagnes dhe partnerit të tij Pablo Silva duke i thënë se shpikja e tij ka ndihmuar lojën në shumë aspekte. Në të shkuarën, FIFA ishte munduar të merrte patentën, për një shumë 500,000 euro por marrëveshja nuk u nënshkrua asnjëherë sipas shpikësit

brazilian. Allemagne thotë se iu deshën 15 vite për të zhvilluar një shkurme që zhduket një minutë pas përdorimit, dhe ai pretendon një kompensim 100 milion euro. Pas zgjedhjes së Infantinos në krye të organizatës, braziliani mendon se ka ardhur momenti për të demonstruar se nuk është një njeri mediokër.

“El Clasico” mund ta vendos top-shënuesin e vitit

Kristiano Ronaldo dhe Lionel Messi, do të përballen me njëri-tjetrin këtë të shtunë në një “El Clasico” të veçantë, ku lufta e tyre do të jetë edhe për ta mbyllur vitin si gola-shënuesi më i mirë. Është mjaft interesant fakti që gjatë vitit 2017, të dy jyet kanë arritur të shënojnë nga 53 gola në të gjitha garat. Por ajo që bie në sy është numri i ndeshjeve të zhvilluar më pak nga Ronaldo, që ka zbritur në fushë 59 herë, katër herë më pak se Messi. Ronaldo ka një mesatare prej 0.90 gola për ndeshje, përkundrajt 0.83 të argjentinasit. Të njëjtën shifër golash në vitin 2017 e kanë edhe Roberto Levandovski i Bajern Muni dhe Edinson Kavani i PSZH-së. Por, të dy nuk kanë më ndeshje për të luajtur në këtë vit. “El Clasico” do të jetë raundi final i duelit Ronaldo – Messi. Kristiano nga 53 gola në total, 42 i ka shënuar me fanellën e Realit: 19 në La Liga, 19 në Ligën e Kampionëve, nga një në Kupën e Mbretit dhe Superkupën e Spanjës dhe dy në Botërorin e Klubeve. 11 golat e tjerë i ka realizuar me Portugalinë. Messi, ndërkohë, nga 53 ka shënuar 49 me “blaugranat” dhe 4 me Argjentinën. La Ligan e mbylli me 39 finalizime, 5 në Kupën e Mbretit, 4 në Ligën e Kampionëve dhe një në Superkupën e Spanjës.

Publicitet

STUHI DIMËRORE PREJ ÇMIMEVE

- Çmime të pabesueshme, shpejtoni dhe kurseni
- Vetura të reja, menjëherë të arritshme
- Sasi e kufizuar e veturave



Përgadituni për minusa.

Qindra minusa të papërsëritshëm ju presin në sallonet e Opel. Zbritje të pabesueshme të çmimeve aktuale të krijuara për fundin e vitit. Shihni ofertën tonë më të mirë deri tani dhe shfrytëzoni mundësinë për të kursyer deri në 1000 euro. Sasitë dhe koha janë të kufizuara. Shpejtoni, ju presim në sallonet e Opel.

opel.mk



E ARDHMJIA I
TAKON TË GJITHËVE

Modeli i shfaqur i veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe shitësit e autorizuar mbajnë të drejtën për të ndryshuar ose tërhequr ofertën në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Për më shumë informacion kontaktoni shitësit e autorizuar Opel. Oferta vlen deri më 31.12.2017.

Auto CEM 044 353 330

Automakedonija 02 310 31 30



DASHI 21. mars - 20. prill

Nëse jeta juaj në çift ka qene e vështirë kohet e fundit, sot gjithçka do sqarohet dhe gjerat do normalizohen ndjeshëm. Mundohuni që edhe gëzimet edhe pengjet t'ia shprehni atij që keni në krah. Beqaret do joshin gjate gjithë kohës, por nuk do arrijnë dot të fillojnë një lidhje. Për financat ka për te qene një dite e shkëlqyer. Me në fund do arrini ta stabilizoni gjendjen dhe do ndiheni te qete.



DEMI 21. prill - 21. maj

Dite shume e kënaqshme ka për te qene kjo e sotmja për te dashuruarit. Si ju ashtu edhe partneri do zgjoheni me optimizëm dhe do i merrni gjerat si t'iu vijnë. Debatet nuk do jene aspak pjese e kësaj dite. Beqaret do turbullohen disi nga një takim që do kenë, por serish do stepen për te hedhur hapa. Në planin financiar gjendja nuk do jete ashtu si ju e keni pritur, prandaj kujdes me çdo shpenzim.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nëse nuk i shtoni dozat e fantazisë gjate kësaj dite, jeta juaj në çift ka për te qene e paqëndrueshme dhe e mbushur me probleme. Një marrëdhënie që te ece mire duhet gjithmonë te jete e mbushur me emocione dhe risi. Beqaret do ua kushtojnë gjithë kohën e lire personave që kane njohur se fundmi dhe do afrohen goxha me ta. Sektori financave nuk do jete aspak problematik.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dite shume pozitive ka për te qene kjo e sotmja për te gjithë ata që janë në një lidhje. Partneri do i përmbushë te gjitha premtimet që ju ka bere me pare dhe do ndiheni te plotësuar. Beqaret nuk duhet ta kërkojnë larg princin e tyre te kaltër sepse do e kenë shume afër atë. Gjendja financiare do filloje te normalizohet goxha pas masave te marra se fundmi. Nuk do keni aspak vështirësi sot.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Fale ambientit te ngrohte yjor, jeta juaj në çift do jete shume me e mire sot. Do i merrni gjerat me pozitivizëm dhe nuk do konfliktoheni për detaje pa vlere. Beqaret me mire te mos i ngatërrojnë çështjet e zemrës me jetën profesionale sepse mund te lëndohen në një moment. Në planin financiar duhet te ndryshoni mënyrën e menaxhimit sepse kështu si keni nisur shume shpejt do ngeleni pa para.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Pasioni, por edhe logjika do jene ato që do i udhëheqin sot juve që jeni në një lidhje. Marrëdhënia me partnerin ka për te qene e jashtëzakonshme në çdo çast. Beqaret duhet te përdorin fjalët dhe gjestet e duhura për te joshur në mënyrë që ta bëjnë për vete atë e pëlqejnë. Për financat mos u shqetësoni pasi gjendja do jete aq e mire saqë mund te bëni edhe investime.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dite pa probleme do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do i kuptoni gabimet e bëra dhe do dini te kërkonit falje në mënyrë nga me te ndryshmet. Beqaret duhet te jene me te rezervuar dhe nuk duhet te tregojnë çdo detaj nga vetja pasi jo te gjithë personat do jene pozitive. Dita nuk do jete e përshtatshme për lidhje. Gjendja financiare do përmirësohet gjithnjë e me tepër kështu që mos u shqetësoni.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Sot duhet te ngrini mure mbrojtëse ju te dashuruarit dhe duhet ta mbronit me çfarë te mundeni jetën tuaj në çift. Shume persona te jashtëm do mundohen t'ua prishin marrëdhënien. Beqaret nuk do kenë ditën me te mire kështu që njëherë për njëherë nuk duhet te hedhin hapa. Në planin financiar tregohuni sa me realiste sepse po bëtë gabime situata do ju dale jashtë kontrollit.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite e mbushur me adrenaline te papare do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Çdo moment për ta do jete i mbushur me kënaqësi dhe emocione shume te veçanta. Kurrë nuk e kishit parashikuar diçka te tille. Beqaret nuk duhet te pranojnë çdo lloj ftese që do ju behet, pasi sot do keni mundësinë e zgjedhjes me te mire. Në planin financiar kërkonit ndihme për te bere një menaxhim me te mire.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite tej mase e qëndrueshme do jete kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Asgjë e keqe nuk ka për te ndodhur mes jush dhe partnerit, përkundrazi bashkëpunimin tuaj do e kenë zili te gjithë. Beqaret do gjenden përballë dilemash te vështira, por në fund do bëjnë zgjedhjen me te mire. Një etape me e bukur do filloje për ta. Buxheti me e fund do jete shume i mire.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Sido që te vijnë punët sot, ju do i jepni prioritet absolut jetës në çift. Do lini çdo gjë tjetër pas dore vetëm që t'i plotësoni çdo dëshirë atij që keni në krah. Beqaret do realizojnë një nga takimet me te veçanta dhe do ndihen menjëherë gati për te hedhur hapa. Sektori i financave nuk do ketë asnjë lloj tronditjeje kështu që mund te shpenzoni qetësisht për gjerat e nevojshme.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Saturni do jete planeti që do ju përkëdhelë në çdo moment gjate kësaj dite dhe do ju beje te përjetoni kënaqësi akoma me te forta. Beqaret po nuk u treguan shume kërkues mund ta gjejnë princin e tyre ta kaltër, ne te kundërt do duhet te presin ende. Me financat nuk keni për te pasur probleme te mëdha, megjithatë mire është që te kujdeseni për shpenzimet dhe te mos jepni para hua.



KOHA	KUPË KAFEJE	AEROPLANË	KRAHINË AUTONOME NË ZVICER	SQUFURI	BAÑOR I ÇAMERISË				KALIJUMI CENTIMETËR
FAKSIMILE					KËNGËTARI ITALIAN, RAMAXOTI				VEGËL BUJQËSORE, LESE
KËNGËTARJA ITALIANE, ZANIKI				DHOMAT E SHKOLLËS ENË QELQI PËR UJË					
LIDHJE					Ë. D. KOREA STANDARD TIME			NUMËR	ISH PORTIERI HOLANDEZ, VAN DER
HIT I KËNGËTARES NË FOTO (JOE, LE TAXI)									
SHPLLIA								VËLLAU I KAINIT	ANGSTREMI
MËMAT								MJET LUFTE	

ZGJIDHJET: VERA, VALON, NIKA, ESAD, SADO, A, ALL, PATA, ÇAM, K, FAKS, EROS, IVA, KLASAT, LINK, ED, NR, KHO TAKSIST, ANONSI, AIN, NËNAT, ARMË.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

6				5	2			4	9				6			
2				6				7	2	4					5	7
	5	8					6	2								1
		5		3				7				7			3	9
				1		5			3			5				2
	4			8		3					9			6		
	6	3				4	5		6	8					9	
5				4				8					3			5
8				1	7			3	5				1	9	4	

Shumë i lehtë: 637952184, 219468537, 458371629, 185234976, 376195842, 942786315, 763829451, 521643798, 894517263. Mesatar: 958167243, 241983576, 736254891, 465721389, 317598624, 829346157, 683475912, 194832765, 572619438.

KETAMINA I LARGON MENDIMET PËR VETËVRASJE



Kur është fjala për parandalimin e vetëvrasjeve, ilaçet vështirë se shpiken. Megjithatë, në vitet e fundit doktorët kanë zbuluar dëshmi bindëse se dozat e vogla të ketaminës - ilaç që përdoret nga doktorët dhe veterinarët për veti anesteziqe - mund të jetë ideal për trajtimin e depresionit. Studimi i ri i publikuar në 'American Journal of Psychiatry' sugjeron se ketamina mund të përdoret edhe si tretman i shpejtë për parandalimin e vetëvrasjeve, transmeton Telegrafi. Në këtë studim, pacientët e depresuar të cilët kishin marrë një infuzion me ketaminë kishin raportuar për heqje të shpejtë të mendimeve për vetëvrasjeve—shumica prej të cilëve kishin raportuar vetëm disa orë pasi e kishin marrë

infuzionin. Autori i këtij studimi, Michael Grunebaum, duke i marrë parasysh eksperimentet të cilat i kanë kryer me ekipin e vet, thotë se trajtimi i mendimeve për vetëvrasje me ketaminë vërtet mund ta ndihmojë dikë që është në gjendje serioze. Efektiviteti i ketaminës mund të demonstrohet edhe nga shumë studime të vogla të cilat janë kryer me vite të tëra, ku 50 apo 60 për qind e njerëzve kanë reaguar mirë ndaj këtij tretmani. Por ketamina nuk është ilaç magjik, sepse efektet e veta besohet të zgjasin vetëm një javë, ndërsa përdorimi i shpeshtë i ketaminës shkakton probleme në kujtesë, dhe përdorimi madh i saj mund të shkaktojë komën dhe vdekjen!

1 në 10 gra janë detyruar nga shefi i tyre të shkojnë në shtëpi të ndërrojnë veshjen

Një në dhjetë gra kanë thënë se janë kthyer në shtëpi nga puna për të veshur një veshje që ishte "më pak zbuluese". Një sondazh i 2 mijë punonjësve të zyrave britanike, ku gjysma e tyre ishin meshkuj dhe gjysma femra, zbuluan se 10 për qind e grave të anketuara ishin urdhëruar të ndryshonin pasi veshja e tyre u konsiderua e papërshtatshme nga shefi i tyre. Veshjet që konsideroheshin "shumë të zbuluara" ishin minifunde, getet e ndryshme. Në krye të 10 për qind të grave dërgohen në shtëpi të për veshur rroba më të përshtatshme në unë dhe 16 për qind e grave thanë se shefi i tyre iu kishte sugjeruar atyre që të mos vishnin më gjëra të zbuluara. Studimi gjithashtu gjeti se 28 për qind e punëtove femra i janë nënshtruar 'komenteve të padëshiruara' rreth paraqitjes së tyre në punë.

"16 VJEÇARËT NË FACEBOOK VETËM ME LEJEN E PRINDËRVE", LIGJI MBËRRIN NË PARLAMENT



"Nëse doni të hapni një profil në rrjetet sociale, merrni leje prindërve". Ky është ligji që do të aplikohet për fëmijët nën 16 vjeç në Francë, i cili u paraqit zyrtarisht edhe në Këshillin e Ministrave dhe në Parlament. Për të mbrojtur të dhënat personale të të miturve, qeveria franceze ka në plan të ndalojë që fëmijët regjistrohen në një rrjet social, siç është Facebook, pa lejen e prindërve. Aktualisht sipas kushteve të përdorimit,

mosha e kërkuar nga Facebook për të hyrë në platformën e saj është 13 vjeç. Por në fakt, të rinjtë regjistrohen duke i dhënë moshën e kërkuar nga rregullorja, pavarësisht nëse kanë arritur ose jo moshën. Si rezultat, prindërit do të jenë ata që do të mbajnë nën kontroll jetën digjitale të fëmijëve të tyre, duke i mbrojtur kështu nga pamjet e dhunshme, ngacmimet, apo rrjetet e përhapura online të pedofilëve.

TALAT PASHA, VEZIRI QË DONTE TË ZHDUKTE NJË KOMB

Kryeministri i Sulltanit të Perandorisë Osmane, ishte përgjegjës për gjenocidin e popullit armen. Aktualisht, shumë amerikanë nuk kanë dëshirë ta cilësojnë atë një gjenocid, pasi Turqia cilësohet si aleat ynë, por ai ishte as më shumë e as më pak një gjenocid. Kjo është edhe arsyeja pse Turqia s'mund t'i bashkohet BE-së, sepse qeveria turke nuk do të pranojë se ishte një gjenocid. Pasha u shpalli më shumë se luftë armenëve. Ai nxori një urdhër për të zhdukur gjithë këtë komb. Armenët u torturuan, përdhuan, vranë dhe iu grabitën të gjitha pronat dhe paratë. Pasha

dhe partnerët e tij i mbyllën armenët në kampet e përqendrimit. Ai i detyroi njerëzit të mbanin mbi shpinë furnizime të rënda, duke i detyruar të ecnin për kilometra të tëra, pa ushqim apo ujë. Në qoftë se ata nuk e përmbushnin këtë detyrë, vriteshin. Shumë individë u detyruan të përdhunojnë familjarët e tyre. Armenët u vranë me shkopin, shtiza, çekiçë, sëpata, bajoneta dhe sharra. Ushtarët e Pashës u prisnin armenëve edhe organet seksuale. Pasha është përgjegjës për vrasjen e gati 1.5 milionë armenë, nga 2.5 milionë që ishin gjithsej para një shekulli.



1790 - Fortesa turke e Izmirit sulmohet dhe okupohet nga Suvorov dhe ushtria e tij ruse.

1815 - Spanjollët ekzekutojnë priftin revolucionar Jose Maria Morelos.

1849 - Anulohet ekzekutimi i Fyodor Dostoevsky-t në sekondën e fundit.

1870 - Jules Janssen, fluturon me balonë për të studiuar eklipsin diellor.

1882 - Fijet e para të dritave për stolisjen e bredhit të Kërshëndellave shpiken për herë të parë nga Thomas Edison.

1922 - Parlamenti belg refuzon Universitetin holandez në Gent.

1940 - Lufta e II Botërore: Himara okupohet nga ushtria greke.

1956 - Trupat e fundit britanike/franceze largohen nga Egjipti.

1963 - Përfundojnë 30 ditë zije për Presidentin John F Kennedy.

1989 - Pas 23 vjet udhëheqjeje diktatoriale, Rumania përzë Nicolae Ceausescu-n.

Personi mesatar konsumon rreth 35 ton ushqim gjatë jetës së tij/saj.



Në trupin tonë ekzistojnë më shumë qeliza bakteriale sesa ato të vetë njeriut.

Sipas një studimi, ne e gjykojmë veten nga qëllimet tona dhe të tjerët nga sjellja e tyre.



TYPING

Djali: Nëna arrita në Durrës.

Nëna: Typing...

Djali: E gjeta një banesë të mirë.

Nëna: Typing...

Djali: Shumë lirë e gjeta.

Nëna: Typing...

Djali: A erdh baba prej pune hala?

Nëna: A mrrine mirë djali im?



Nuk mund të të them me saktësi cili është çelësi i suksesit, por di të të them se çelësi i dështimit është përpjekja për të kënaqur të tjerët.

(ED SHEERAN)



KALENDARI HISTORIK 22 DHJETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS